

UNIVERSITETI I EVROPES JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULTETI I DREJTËSISË
ПРАВЕH ФАКУЛТЕ
FACULTY OF LAW

STUDIME PASDIPLOMIKE-CIKLI I DYTË

TEZA:

**VEPRAT PENALE QË RREZIKOJNË SIGURINË E REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË**

KANDIDATI:

Elzana Mustafi

MENTORI:

Prof. Dr. Jeton Shasivari

Tetovë, 2019

PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	4
HYRJA	5
Qëllimi i punimit	7
KAPITULLI PARË	9
VËSHTRIMI HISTORIKO-JURIDIK I VEPRAVE PENALE KUNDËR SHTETIT DHE VEPRAVE PENALE KUNDËR RENDIT PUBLIK DHE FAKTORËT QË NDIKOJNË NË KRYERJEN E TYRE	9
1.Zhvillimi historik i veprës penale kundër shtetit dhe veprës penale kundër rendit publik.....	9
2. Faktorët që ndikojnë në kryerjen e veprave penale kundër shtetit dhe veprave penale kundër rendit publik.....	10
2.1Faktorët ekonomik.....	10
2.2Mosrespektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut si faktorë kryesorë i veprave penale kundër shtetit dhe veprave penale kundër rendit publik.....	11
KAPITULLI I DYTË	16
LLOJET E VEPRAVE PENALE KUNDËR SHTETIT	16
1.Emërtimet ligjore të veprave penale kundër shtetit sipas kodit penal të R.M.....	16
2. Disa nga veprat penale që rrezikojnë sigurinë e R.M.-së.....	23
2.1 Emërtimet ligjore të veprave penale kundër rendit publik sipas kodit penal të RM.....	23
3. Trajtimi i veprës penale kundër shtetit dhe veprës penale kundër rendit publik sipas:.....	25
3.1 Kodit penal të RM-së.....	25
3.2 Kodit penal të Republikës së Shqipërisë.....	26
3.3 Kodit penal të Republikës së Kosovës.....	27
KAPITULLI I TRETË	30
SANKSIONET PENALE TË VEPRAVE PENALE KUNDËR SHTETIT SIPAS KODIT PENAL TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË	30
1. Sanksionet e shqiptuara kundër kryerësve të veprave penale kundër shtetit dhe veprave penale kundër rendit publik në gjykatat e R.M-së.....	30
KAPITULLI I KATËRT	36
INSTITUCIONET SHTETËRORE QË JANË PËRGJEGJËSE PËR SIGURINË E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË	36
1. MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME.....	36
2. Organet e MPB-së.....	38
2.1 Biroja për siguri publike.....	39
2.2 Drejtoria për siguri dhe kundërzbulim.....	41
3. Ministria e Mbrojtjes.....	43
4. Organet e Ministrisë së Mbrojtjes së RM-së.....	45
5. Roli i Ministrisë së Mbrojtjes në rruajtjen e stabilitetit dhe sigurisë.....	46
6. Sfidat e Ministrisë së Mbrojtjes si garancion për qytetarët.....	46
KAPITULLI I PESTË	49
MEKANIZMAT JURIDIKË NË RM, TË CILAT GARANTOJNË SIGURI DHE STABILITET NË RM	49

DOKUMENTET STRATEGJIKE TË MIRATUARA PËR MBROJTJE DHE SIGURI TË RM-SË	49
1. Libri i Bardhë i Mbrojtjes.....	49
2. Strategjia e Mbrojtjes së R.M-së.....	50
3. Marrëveshja Kornizë e Ohrit.....	52
4. Koncepti nacional për siguri dhe mbrojtje.....	56
5. Plani afatgjatë për zhvillimin e mbrojtjes për periudhën kohore 2011-2020.....	58
6. Roli i organizatave ndërkombëtare.....	59
7. Vetëorganizimi i shoqërisë civile.....	60
KAPITULLI I GJASHTË	62
ANALIZË E SITUATËS AKTUALE NË RM	62
1. Ballafaqimi i RM-së me problemet e jashtme.....	62
2. Ballafaqimi i RM-së me problemet e brendshme të shtetit.....	64
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	68
BIBLIOGRAFIA	70

SHKURTESAT

RM-Republika e Maqedonisë

RSH-Republika e Shqipërisë

RK-Republika e Kosovës

RS-Republika e Sërbisë

SHBA-Shtetet e Bahkuara të Amerikës

UE-Unioni Evropian

KEDN-Konventa Evropiane Për Të Drejtat e Njeriut

KE-Këshilli Evropian

GJTH-Gjykata Themelore

KP-Kodi Penal

LPP-Ligji për Procedurë Penale

VP-Veprat Penale

MPB -Ministria e Punëve të Brendshme

MM- Ministria e mbrojtjes

MO -Marrëveshja e Ohrit

ARM-Armata e Republikës së Maqedonisë

HYRJE

Siguria e një vendi është një kusht esencial për zhvillimin dhe përparimin e tij. Konfliktet mbrenda një territori të shtetit jo vetëm që shkatërojnë infrastrukturën e vendit ato shkatërojnë edhe infrastrukturën sociale dhe rrisin kriminalitetin në vend, zvogëlojnë investimet si të huaja edhe ato të brendshme me ç'rast shkaktohet ngecje në zhvillimin ekonomik të një vendi.

Sistemi i sigurisë së një vendi duhet të jetë i orientuar në mirrëmbajtjen e sigurisë në aspektin ekonomik, diplomatik si dhe në aspektin politik.

Rruajtja e integritetit dhe sovranitetit duhet të jetë qëllim parësor i shtetit, duke luftuar me një përkushtim afatgjatë kundër shumë formave të rënda të kriminalitetit, nëpërmjet strukturave dhe subjekteve kompetente të paraparë me ligj për funksionimin e mirëfilltë të këtij sistemi.

Republika e Maqedonisë si shtet i pavarur, që nga ndryshimet kushtetuese me 17 dhjetorë të vitit 1991, filloi të ndërtojë një sistem të pavarur të sigurisë.

Ky ndërtim dhe transformim i sektorit për siguri duhej të ishte i orientuar në implementimin e principit për qeverisje të mirë, që do të thotë përgjegjësi dhe transparencë të organeve shtetërore, principe këto që janë çelsi i integriteteve euroatlantike. Kjo do të thotë se përshtatshmëria në sektorin e ndërtimit të sigursë se R.M-së si kandidat për anëtarësim në BE dhe Nato, me kriteret e vendeve anëtare është i pashmangshëm.

Sfidat e R.M-së në periudhën e tranzicionit, si kriza ekonomike, lufta dhe konflikti në vend, e karakterizuan periudhën e transformimit të sistemit juridik të vendit. Këto sfida rezultuan me paraqitjen e disa formave të kriminalitetit, si rritje të dhunës, krimet të organizuar si dhe rritje të tensioneve ndëretnike të cilat kontribuan edhe më shumë në përkeqësimin e procesit të brendshëm të demokracisë dhe në garantimin e funksionimit të shtetit si shtet i së drejtës.

Gjithashtu edhe ngecja në reformat institucionale sa i përket respektimit të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, paraqitet si sfida e shtetit për përparimin e tërësishëm të sigurisë së brendshme të shoqërisë dhe shtetit.

Integrimi i bashkësive etnike në R.M-së në një sistem shtetëror multietnik është baza imperative për sigurinë e R.M-së. Në këtë drejtim duhet të bëhen përpjekje maksimale për implementimin e dispozitave për barabarësi të bashkësive etnike në R.M-së.¹

Është shumë me rëndësi të potencohet se në Republikën e Maqedonisë duhet të egzistojnë mekanizma të drejtë institucional që do të ndikojnë në reformat dhe ndërtimin e sigurisë ku në mënyrë efikase dhe profesionale do t'iu kundërviheshin kërcënimeve për destabilizimin e sigurisë.

¹ Fjalim në konferencën ndërkombëtare- Reformat në sektorin e sigurisë së R.M-së dhe ndikimi i tyre në luftën kundër kriminalitetit e mbajtur më 15.09.2012 në UEJL, fq.24

QËLLIMI I PUNIMIT

Republika e Maqedonisë paraqet shtet që aspron strukturat europiane dhe euroatlantike për të siguruar benefitet në aspektin e sigurisë ekonomike si dhe sigurisë së përgjithshme në vend. Aktualisht vendi po përballet me probleme të brendshme që shfaqen me prishjen e marrëdhënieve ndëretnike, krizën e madhe ekonomike, krimin e organizuar, korrupsionin, mosfunksionimin e shtetit ligjor, mungesën e kapacitetit demokratik dhe konsenzusit për interesat parrësore nacionale si dhe me probleme në sferën e jashtme me shtetet fqinje si Greqia, Bullgaria, Serbia, Shqipëria dhe Kosova. Të gjitha këto paraqesin potencial kryesor për rrezikimin e stabilitetit, sigurisë dhe funksionimit si shtet multietnik në rajon.

Ngjarjet e fundit rezultuan me prishjen e rendit dhe sigurisë së Republikës së Maqedonisë. Si rrjedhojë patëm reagimin e bashkësisë ndërkombëtare që iniconte zgjidhjen e menjëhershme dhe efikase të problemeve të sigurisë në kuptim të eliminimit të grupeve kriminale të caktuara në vend dhe eliminimit të ideve të disa strukturave shtetërore që pengojnë afrimin e interesave të përbashkëta ndëretnike dhe ndërtimin e rendit demokratik dhe të barazisë kushtetuese. Këto ide që kërcënojnë kultivimin e raporteve të mira ndëretnike, ngritjen e nivelit të demokracisë, respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, mirëqenien ekonomike dhe sociale, drejtpërsëdrejti kontribuojnë në paraqitjen e një forme të kriminalitetit e cila është ndër më të vjetrat sa edhe vet njerëzimi.

Faktorët e lartpërmendur kanë ndikim parrësor në kryerjen e këtyre veprave penale, andaj kjo dukuri mjaft komplekse dhe problematike për shoqërinë tonë më motivoj që t'i bëjë një analizë të thellë shkencore këtij problemi me një përkushtim dhe angazhim maksimal duke diskutuar mekanizmat për ndërtimin e raporteve ndërnjerëzore brenda një shteti dhe ndërmjet shteteve si dhe faktin se Maqedonia si shtet me këta kufijë, territor dhe përbërje multietnike duhet t'u nënshtrohet rregullave dhe standardeve që i ofron Bashkimi Europian dhe Nato për të arritur progres dhe kënaqësi në masë, me qëllim të parandalimit të këtij fenomeni aq të dëmshëm për shtetin.

Këto forma të kriminalitetit që rrezikojnë sigurinë e Republikës së Maqedonisë, në kodin penal të vendit parashihen si vepra penale kundër shtetit të parashikuara nga neni 305 deri në nenin

327 të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë si dhe vepra kundër prishjes së rendit publik (disa nga ato) të parashikuara ne nenin 386- Dhuna, neni 388-Ndryshimi i kundërligjshëm i ndarrjes territoriale të Republikës se Maqedonisë, neni 394-a Organizata terroriste, neni 394-b Terrorizmi dhe neni 394-c Financimi i terrorizmit.

KAPITULLI I PARË

VËSHTRIMI HISTORIKO-JURIDIK I VEPRAVE PENALE KUNDËR SHTETIT DHE

VEPRAVE PENALE KUNDËR RENDIT PUBLIK DHE FAKTORËT QË NDIKOJNË NË

KRYERJEN E TYRE

1. Zhvillimi historik i veprës penale kundër shtetit dhe veprës penale kundër rendit publik

Taktikat kriminalistike në epoka të ndryshme historike, njerëzit i kanë përdorur dhe kryer në mënyra të ndryshme. Evoluimi i tyre pësoi ndryshime që nga fillimi i historisë e deri në ditët e sotme.

Veprat penale si terrorizmi, sabotimi, diverziteti dhe spiunimi si taktika tradicionale kriminalistike në zhvillimin e civilizimit njerëzor janë manifestuar në atentate, kidnapime dhe kapjen e robërve.

Në këtë kontest historik është shumë me rëndësi të potencohet se në kohën parahistorike kryerja e ndonjë atentati mbi udhëheqësit tiran jo vetëm që ka qenë i falur por edhe i lavdëruar dhe i respektuar si akt shpëtimi.

Në kohën paramoderne dhuna mendohej se është alternative e vetme drejt një sistemi më të mirë politiko-shtetëror.

Është me rëndësi të potencohet rasti i atentatorëve në Persi dhe Asiri të cilët në shekullin e njëmbëdhjetë, përhapën një frikë të madhe dhe terror në të gjithë perandorinë islamike.²

Në kohën e revolucionit francez në shekullin e tetëmbëdhjetë, njëri nga dymbëdhjetë krerët e shtetit të ri vrau 40000 njerëz si armiq të e revolucionit duke përdorur terrorizmin me qëllim të shkatërrimit të pjesës më të madhe të aristokracisë duke instaluar një diktaturë për stabilizimin e vendit.

² Kotovcevski.M, Sovremen terorizam, Makedonska civilizacija, Skopje, 2003, fq.19

Kjo periudhë e përgjakshme gjatë revolucionit francez njihet si periudha ku u hodhën themelet e terrorizmit modern.

Zanafila historike e këtyre veprave penale është po aq e vjetër sa edhe vet gadishmëria e njeriut për të përdorur dhunën për të ndikuar te politika, si përdorim jo ligjor i dhunës, terrorit dhe shkëmbim të informacioneve nga ana e disa grupeve ose grupeve të tjera të cilat kanë lidhje direkte me forcat e jashtme të cilat aktivitete i tejkalojnë kufijtë nacional të drejtuar kundër individëve të caktuar ose objekteve me qëllim frikësimit të shoqërisë për arritjen e realizmit të qëllimeve politike.

2. Faktorët që ndikojnë në kryerjen e veprave penale kundër shtetit dhe veprave penale kundër rendit publik

2.1. Faktorët ekonomik

Sjelljet njerëzore si dukuri mjaft komplekse të ndikuara nga faktorë të ndryshëm ekonomiko-social luajnë rol të rëndësishëm në kryerjen e veprave penale në përgjithësi. Ndikimi i madh që kanë kushtet e vështira ekonomike si faktorë objektiv të kriminalitetit ndikon në paraqitjen e sjelljeve kriminale të cilat dretjtpërsëdrejti vështirësojnë egzistencën e popullsisë.

Varfëria dhe papunësia luajnë rol të madhë në paraqitjen e çrregullimeve individuale dhe kundërthënieve mbrenda në familje dhe në grupe të ndryshme shoqërore. Kjo gjendje ushtron efekte negative në aspektin social në të cilën shoqëria sheh vëtëm pa perspektivën.

Frustracionet, zhgënjimet, zemërimet si shkak i papunësisë në Republikën e Maqedonisë janë në rritje të vazhdueshme. Kjo ngecje ekonomike vazhdon të bëjë presion të vazhdueshëm mbi shumë familje në Maqedoni. Si fenomen ekonomik në vendin tonë, kapaciteti i Maqedonisë për të gjeneruar vende të reja të punës nuk është i pritshëm si pasojë e politikës së deritashme në përgjithësi.

Papunësia është e ngjajshme me dukurinë e varfërisë dhe ka të bëjë me pamundësinë e punësimit dhe kyçjes në punë të njerëzve, e kjo sjell mungesën e mjeteve për egzistencë. Papunësia si dukuri dhe problem social, veçmas vjen në shprehje gjatë krizave dhe

recenzioneve ekonomike.Papunësia ndikon në keqësimin e pozitës materiale të individëve dhe familjeve.Nëse kjo dukuri zgjatë më tepër atëherë sjell varfëri dhe skamje të madhe. Gjendja e papunësisë ushtron efekte negative si në aspektin social ashtu edhe në atë individual.³

Agjencioni për punësim i R.M-së në raportin vjetor për vitin 2016, raporton se në bazë të vendit të jetesës, papunësia është e përhapur në mjediset urbane, ku në bazë të numrit të qytëtarëve, në qytetin e Shkupit dhe në qytetin e Tetovës janë të evidentuar numri më i madh i të papunësuarve. Nga të dhënat zyrtare të agjencionit për punësim për vitin 2016 raportohet se Shkupi dhe Tetova kryesojnë me numrin më të madh të të papunësuarëve.Në Shkup ky numër arrijnë deri në 15822, ndërsa në Tetovë kjo shifër është shumë e madhe, deri në 13751 të papunësuar.⁴

2.2 Mosrespektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut si faktorë kryesor i veprave penale kundër shtetit dhe veprave penale kundër rendit publik

Njerëzit që për kah natyra janë të barabartë, duhet të kë në gjithashtu për kah natyra të drejta të barabarta dhe dinjitet të barabartë...Aristoteli.

Respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut paraqet një nga vlerat më të rëndësishme për çdo shtet ligjor dhe demokratik.Demokracia e një vendi nuk mund të paramendohet dhe të realizohet pa një angazhim të qartë, vendosmëri dhe garanci kushtetuese dhe ligjore të të drejtave dhe lirive të qytetarëve.⁵

Të drejtat dhe liritë themlore të njeriut në R.M-së janë të parapara në nenin 8 të Kushtetutës së R.M-së.Këto të drejta cilësohen si vlera themelore të rendit kushtetues, të njohura nga e drejta ndërkombëtare.Sipas këtij neni:

Vlerat themelore të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë janë:

- liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe të qytetarit, të njohura me të drejtën ndërkombëtare dhe të përcaktuara me Kushtetutë;
- të shprehurit e lirë të përkatësisë kombëtare;

³Alili Ragib, Kriminologji, Prishtinë, 2008, fq.249

⁴www.avrm.gov.mk-Tëdhena zyrtare nga Agjencioni per punësim i R.M-së për vitin 2016

⁵ Shabani Fisnik, Mekanizmat juridike për mbrojtjen e lirive dhe te drejtave te njeriut ne R.M, Tetovë, 2016, fq.18

- sundimi i së drejtës;
- ndarja e pushtetit shtetëror në ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor;
- pluralizmi politik dhe zgjedhjet e lira, të drejtpërdrejta dhe demokratike;
- mbrojtja juridike e pronësisë;
- liria e tregut dhe e sipërmarrësisë;
- humanizmi, drejtësia sociale dhe solidariteti;
- vetadministrimi lokal;
- rregullimi dhe humanizimi i hapësirës dhe mbrojtja dhe përparimi i mjedisit jetësor dhe i natyrës dhe
- respektimi i normave përgjithësisht të pranura të së drejtës ndërkombëtare.

Në Republikën e Maqedonisë është e lirë çdo gjë që nuk është e ndaluar me Kushtetutë dhe me ligj.⁶

Siç shihet në këtë nen radhitet edhe shprehja e lirë e identitetit kombëtar, sundimi i ligjit dhe respektimi i normave përgjithësisht të pranura në të drejtën ndërkombëtare, si të drejta bazike për një shtet multietnik siç është R.M-së, respektimi i të cilëve do të thotë siguri për një shtet.

Të drejtat civile dhe ato politike, të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, si dhe garancitë e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut janë të përcaktuara në kapitullin e 2 të kushtetutës.

Kushtetuta njëkohësisht ofron edhe garanci dhe instrumente më konkrete për zbatimin e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Si institucione kryesore të parapara me kushtetutë dhe ligje të veçanta të cilat institucione veprojnë në Republikën e Maqedonisë janë:

- Komisionet parlamentare, Avokati i Popullit;
- Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
- si dhe një numër organesh të tjera në kuadër të vetëqeverisjes lokale.

⁶ Kushtetuta e R.M-së, Neni 8, Gazeta zyrtare nr.4642/1, 17 nëntor 1991, Shkup

Duke patur parasysh faktin që R.M-së është kandidat për anëtarimin në BE, është shumë e rëndësishme që direktivat e BE-së për të drejtat e njeriut të zbatohen plotësisht në legjislacionin e brendshëm të shtetit.

Ky legjislacion i R.M-së pothuajse në çdo dokument strategjik për mbrojtjen dhe sigurinë e R.M-së (që do të cekim më poshtë), si interesa vitale për funksionimin stabil të shtetit, përparësi u jep respektimit të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.

Edhe pse kushtetuta e Republikës së Maqedonisë garanton liritë dhe të drejtat e njeriut të parapara edhe në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikura, prap se prap shkelja e tyre është e dokumentuar nga të dhënat zyrtare dhe raportet e vlerësimit të Komisionit Evropian dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Nga këto raporte qartë mund të lexohen shqetësimet e komunitetit ndërkombëtar në lidhje me situatën aktuale të lirive dhe të drejtave të njeriut në vend, kritikata, sugjerimet me theks të veçantë mbi fusha të caktuara si liria e shprehjes dhe lëvizjes, lufta e sektorit civil, ngecja dhe moszgjidhja e kontesteve civilo-juridike nëpër gjyqe etj.

Në formën më të vrazhdë në R.M-së janë mjaftë të përhapura jo barazia dhe diskriminimi. Barazia përkufizohet si trajtim i barabartë ndaj të gjithëve. Sipas këtij parimi të gjithë njerezit duhet të konsiderohen të njejtë dhe të barabartë në aspektin e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Diskriminimi gjithashtu është mjaft i përhapur në R.M-së veçanërisht diskriminimi etnik, racor dhe gjinor.

Nga Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi i themeluar në bazë të ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi kanë arritur statistika.

Sipas institucionit të avokatit të popullit, veprimi sipas lëndëve në vitin 2016, në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi, për dallim nga dy vitet e mëparshme, shënon rritje për rreth 20%, me ç'rast me numër më të madh janë parashtrës që kanë të bëjnë me diskriminimin në sferën e marrëdhënies së punës. Nuk janë zvogëluar ankesat e qytetarëve për diskriminim në baza

etnike, pastaj pasojnë parashtresat për mbrojtje nga shqetësimet apo mobingu në vendin e punës, dhe për diskriminim në bazë të përdorimit të gjuhës.⁷

Gjithashtu një fakt shqetësues për Avokatin e Popullit është edhe mosrespektimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve të cilën e flasin të paktën 20% e qytetarëve të R.M-së nga ana e institucioneve shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale. Këto të dhëna rezultojnë nga parashtresat nga qytetarët e komunitetit shqiptar në bazë të gjuhës. Një shembull i kësaj natyre është edhe një parashtresë e paraqitur nga një qytetar shqiptar.

AP nr. 3988/15- Deri te Avokati i Popullit u parashtrua parashtresë nga një qytetar, pjesëtar i bashkësisë etnike shqiptare, i cili u ankua se diskriminohet në bazë të përdorimit të gjuhës, për shkak se në procedurë administrative nuk i lejohet përdorimi i gjuhës amtare nga ana e Ministrisë për Punë të Brendshme gjatë procedurës së dërgimit të akteve dhe korrespondencës me organin. Pas grumbullimit të të gjitha fakteve relevante nga palët e involvuara, Avokati i Popullit konstatoi shkelje të normave të përcaktuara të cilat janë paraparë me kornizën ligjore të vendit. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit dërgoi sugjerim në të cilin potencoi se është e nevojshme që në procedurën e kundërvajtjes, të cilën e udheheq sektori kompetent, në mënyrë konsekuente të zbatohen dispozitat e nenit 2, paragrafi 2 të Ligjit për kundërvajtje, neni 8-11 i Ligjit për procedurë penale dhe nenet 5-9 të Ligjit për përdorimin e gjuhës që e përdorin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale, si dhe respektimin e dispozitës së nenit 3 të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Pas dërgimit të sugjerimit, Avokati i Popullit u njoftua, me dëshmi konkrete, se është vepruar sipas sugjerimit, me çka parashtruesi i parashtresës e realizoi të drejtën e tij.⁸

Sipas disa statistikave dhe të dhënave, nga Avokati i Popullit u raportuan disa të dhëna për vitin 2016, në shkëlqjen e lirive dhe të drejtave të qytetarëve.

Nga ky institucion gjithsej janë pranuar 3.775 parashtresa edhe atë:

⁷ www.ombudsman.mk-Të dhëna statistikore nga raporti vjetorë i Avokatit të popullit për vitin 2016

⁸www.ombudsman.mk-Raporti vjetor i vitit 2017

-1.764 ose 46.73% kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave nga ana e institucioneve dhe shërbimeve publike,

-1.142 ose 30, 25% kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave nga ana e pushtetit qendror,

-në 306 parashtresa ose 8, 11% janë cënuar të drejtat nga ana e pushtetit lokal,

-në 192 parashtresa ose 5, 09% janë cënuar të drejtat nga ana e personave juridikë,

-në 33 parashtresa ose 0, 87% ka pasur cënim të të drejtave si nga pushteti qendror ashtu edhe nga pushteti lokal,

-ndërsa në 338 parashtresa ose 8, 95% parashtresit janë ankuar për cënimin e të drejtave nga subjekte të tjera.

Në pjesën e mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe adekuat janë pranuar 69 parashtresa nga të cilat:

- 18 kanë të bëjnë me diskriminimin në marrëdhëniet e punës,

-kurse 17 kanë të bëjnë me diskriminimin mbi baza etnike.

Nga këto të dhëna zyrtare nga Avokati i Popullit është e konstatuar qartë se mosrespektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë si një shtet pluralist mbi njëzet vjeçar të qeverisjes demokratike cënon procesin e mëtutjeshëm të avancimit të shoqërisë në integrimin në strukturat euroatlantike.

KAPITULLI I DYTË

LLOJET E VEPRAVE PENALE KUNDËR SHTETIT

1. Emërtimet ligjore të veprave penale kundër shtetit sipas kodit penal të RM-së

Forma të kriminalitetit që rrezikojnë sigurinë e Republikës së Maqedonisë, në kodin penal të vendit parashihen si vepra penale kundër shtetit të parashikuara nga neni 305 deri në nenin 327 të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë.

Neni 305 i Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë parasheh veprën penale **Tradhëtia e madhe**.

Sipas paragrafit 1 të këtij neni, këtë vepër penale e kryen ai i cili me përdorim të forcës ose të kërcënimit serioz do të ndërrojë rendin kushtetues të Republikës së Maqedonisë apo ti rrezojë organet më të larta shtetërore.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në a) përdorimin e forcës apo kanosjes serioze me çka tentohet të ndërrohet kryetari i shtetit dhe b) përdorimin e forcës apo të kanosjes serioze.

Pranimi i pushtimit okupimit

Kjo vepër penale parashihet në nenin 306 të Kodit Penal të R.M-së

Kryerësi i kësaj vepre mund të jetë çdo qytetar i R.M-së i cili do të pranojë pushtimin e Republikës së Maqedonisë apo të ndonjë pjesë të caktuar të saj.

Rrezikimi i tërësisë territoriale

Neni 307 i Kodit Penal të R.M-së parasheh veprën penale “rrezikimi i tërësisë territoriale”. Sipas paragrafit të parë këtë vepër penale e kryen ai i cili me përdorimin e forcës apo me kërcënim serioz, me përdorim të forcës do të tentojë të pushtojë, ndajë pjesë të territorit të Republikës së Maqedonisë apo pjesë të këtij teritori kurse paragrafi i dytë parashef kryerësin e veprës

penale i cili me përdorim të forcës apo me kërcënim serioz të përdorimit të forcës do të tentojë t'ia ndëroj kufijtë Republikës së Maqedonisë.

Rrezikimi i pavarësisë

Sipas këtij neni kryerës i veprës penale mund të jetë çdo qytëtar i Republikës së Maqedonisë i cili do të sjellë R.M-së në pozitë të nënshtrimit apo të barazisë ndaj ndonjë shteti tjetër.

Vrasja e përfaqësuesve të organeve me të lartë shtetërorë

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në rrezikimin e rendit kushtetues apo sigurinë e Republikës së Maqedonisë. Konsiderohet se kryhet nëse kryerësi qëllimisht do ta privoj nga jeta Kryetarin e R.M-së, kryetarin e kuvendit, Kryetarin e qeverisë, gjykatës kushtetuese ose gjykatës supreme të R.M-së ose prokurorin publik të R.M-së.

Rrëmbimi i përfaqësuesve të organeve më të larta shtetërore

Paragrafi 1 i kësaj vepre penale parasheh se kjo vepër penale kryhet me qëllim të rrezikimit të rendit kushtetues ose sigurisë së R.M-së me rrëmbim të përfaqësuesve të organeve më të larta shtetërore.

Me rrëmbimin e përfaqësuesve nënkuptohet marrja me dhunë e subjektit pasiv nga vendi ku është takuar dhe dërgimi në vend tjetër.⁹

Dhuna ndaj përfaqësuesve të organeve më të larta shtetërore

Kryerësi i kësaj vepre penale ka për qëllim rrezikimin e rendit kushtetues apo sigurinë e Republikës së Maqedonisë me forcë apo me kërcënim serioz për ta penguar të bëjë dicka ose do ta detyrojë të bëjë apo të detyrojë të mos të bëjë gjatë ushtrimit të detyrës së tij, Kryetarin e Republikës, kryetarin e qeverisë, gjykatës kushtetuese ose gjykatës supreme të R.M-së ose prokurorin publik të R.M-së.

⁹ Zejneli Ismail, E drejta penale-pjesa e posaçme, Tetovë, 2007, fq.142

Kryengritja e armatosur

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person, në cilësinë e organizatorit apo si shtytës i kryengritjes i cili merr pjesë në kryengritje të armatosur drejt rezikimit kushtetues ose të sigurisë së Republikës së Maqedonisë

Kërcënimi terrorist i rendit kushtetues dhe sigurisë

Neni 313 i referohet kërcenimit terrorist të rendit kushtetues dhe sigurisë në vend. Kryerësi ka për qëllim që ta rrezikojë rendin kushtetues apo sigurinë e Republikës së Maqedonisë që ta shkaktojë apo seriozisht të kërcënojë me shkaktimin e eksplodimit, vërshimit apo të ndonjë veprimi tjetër në rrezik të përgjithshëm apo të aktit të dhunës, duke krijuar ndjenjë të pasigurisë apo të frikës te qytetarët.

Diversioni

Diversioni si vepër penale në Kodin Penal të R.M-së parashihet në nenin 314. Qëllimi kryesor i kryerësit të kësaj vepre është rrezikimi i rendit kushtetues dhe sigurisë së R.M-së me shkatërrimin apo dëmtimin e ndonjë objekti industrial, bujqësor osë ndonjë objekti tjetër ekonomik, mjet komunikacioni, sistem për lidhje, sistem për furnizim me ujë, gaz ose lloj tjetër të energjisë, pendë apo objekt tjetër të rëndësishëm për jetën e qytetarëve.

Sabotimi

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo qytetarë i cili gjatë ushtrimit të detyrës së vetë të punës në menyrë të fshehtë apo tinzare do të shkaktojë dëm të konsiderueshëm organit shtetëror, instucionit apo personit juridik në të cilin punon me qëllim të rrezikimit të rendit kushtetues apo sigurisë së Republikës së Maqedonisë.

Spiunimi

Këtë vepër penale kryerësi e kryen nëpërmjet dhënies apo dorzimit të sekretit shtetëror organizatës ose personit të huaj që u shërben.

Në paragrafin e 2 kryerësi do të krijojë shërbim zbulimi në Republikën e Maqedonisë ose do të udhëheqë me të.

Në paragrafin e 3 të këtij neni kryerësi do të hyjë në shërbim të huaj zbulimi ose do të grumbulloj të dhëna për këtë shërbim apo në menyrë tjetër do t'a ndihmojë punën e shërbimit të huaj.

Veprimi i kryerjes në paragrafin e 4 konsiston në mbledhjen e dokumenteve sekrete me qëllim që t'ia kumtojë apo dorrëzojë shtetit, organizatës apo personit të huaj të cilëve u shërben.

Si sekret shtetëror llogariten të dhënat apo dokumentet që me ligj apo dispozitë tjetër apo me vendim të organit kompetent, të marra në bazë të ligjit, janë shpallë për fshehtësi shtetërore dhe zbulimi i të cilëve ka pasur apo ka mundur të ketë pasoja të dëmshme për interesat politike, ekonomike ose ushtarake të Republikës së Maqedonisë.¹⁰

Dhënia e sekretit shtetëror

Dhenia e sekretit shtetëror si vepër penale përfshin dorrëzimin apo kumtimin e sekretit shtetëror ose do t'ia bëjë të kapshme, publikut apo personit jo kompetent.

Sipas paragrafit të dytë këtë vepër penale e kryen ai i cili publikut apo personit të paautorizuar do t'i kumtojë, dorrëzojë apo do t'ia bëjë të kapshme të dhënat apo dokumentat për të cilat e di se janë në fshehtësi shtetërore të cilat kanë ardhur në menyrë të kundërligjshme.

Thirrja për ndryshim të dhunshëm të rendit kushtetues

Kryerësi i kësaj vepre penale e inicon në kryerje të drejtëpërdrejtë apo e përkrah kryerjen e veprave penale nga nenet 307 deri në nenin 317 qëllimi i të cilit është padryshim rrezikimi i rendit kushtetues dhe siguria e Republikës së Maqedonisë.

¹⁰Osmani Afrim, Kodi penal I R.M-së, Shkup, 2015, fq.266

Shkaktimi i përçarjes dhe mosdurimit në baza nacionale, racore, fetare dhe në baza të tjera diskriminuese.

Kryerës i kësaj vepre penale është ai i cili me shtrëngim, keqtrajtim, rrezikim të sigurisë, vënie në tallje të simboleve nacionale, etnike, fetare apo simboleve tjera, me nderje me shkatërrim apo në mënyrë tjetër, me dëmtim të flamurit të Republikës së Maqedonisë ose flamujve të shteteve të tjera, me dëmtim të sendeve të huaja, me përdhosje të përmendoreve, varrezave apo në mënyrë tjetër diskriminuese, drejtpërdrejtë apo jo drejtpërdrejtë do të shkaktojë apo nder urretje, përçarje apo mosdurim në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, afërsisë, përkatësisë së grupit të marginalizuar, përkatësisë nacionale, gjuhës, shtetësisë, prejardhjes sociale, religjionit apo bindjes fetare apo formave të tjera të bindjes, arsimit, përkatësisë politike, statusit personal apo shoqëror, paaftësitë mentale apo trupore ,moshës, gjendjes familjare apo martesore, statusit pasuror, gjendjes shëndetësore, apo në çfardo qoftë baze tjetër e paraparë me ligj apo me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare.¹¹

Cënimi i sovranitetit territorial

Kjo vepër penale parashihet në nenin 320 të Kodit Penal të R.M-së Kryerës i kësaj vepre penale është personi i cili duke shkelur rregullat e të drejtës ndërkombëtare do të hyjë në territorin e Republikës së Maqedonisë me qëllim të rrezikimit të rendit kushtetues apo sigurisë e vendit.

Pengimi i luftës kundër armikut

Kryerës i kësaj vepre penale është çdo qytetar i Republikës së Maqedonisë i cili gjatë kohës së luftës apo konfliktit të armatosur i pengon qytetarët e Republikës së Maqedonisë apo qytetarët e aleatëve të saj të zhvillojnë luftë kundër armikut.

Shërbimi në ushtrinë e armikut

Ky nen parashef 2 paragrafe. Sipas paragrafit të parë qytetari i Republikës së Maqedonisë i cili shërben armikun ose formacione të tjera të armatosura gjatë kohës së luftës apo konfliktit të

¹¹Osmani Afrim, Kodi penal i R.M-së, Shkup, 2015, fq.267

armatosur apo merr pjesë në luftë ose në formacione të tjera të armatosura si luftëtar kundër R.M-së.

Në paragrafin e dytë kryerësi i veprës penale rekruton qytetar të Republikës së Maqedonisë për t'u shërbyer armikut ose për pjesëmarrje në luftë apo konflikt të armatosur kundër R.M-së.

Pjesëmarrja në ushtrinë, policinë, formacionet paraushtarake dhe parapolicore të huaj

Kryerës i kësaj vepre penale është ai i cili në kundërshtim me ligjin krijon, rekruton, bartë, organizon transport, pajis, trajnon apo në mënyrë tjetër përgayit persona apo grup për pjesëmarrje në ushtrinë, policinë, formacionet paraushtarake apo parapolicore të huaj, grupe të organizuara apo individualisht, jashtë nga territori i Republikës së Maqedonisë.

Ai i cili në kundërshtim me ligjin në çfarë do qoftë menyre direkte apo indirekte, ofron, jep, siguron, kërkon, grumbullon apo fsheh mjete financiare, fonde, mjete materiale apo paisje të cilët tërësisht apo pjesërisht janë të destinuara për kryerjen e veprës nga paragrafi 1 të këtij neni.

Shtetasi i Republikës së Maqedonisë i cili në kundërshtim me ligjin merr pjesë apo trajnohet nga ana e ushtrisë, policisë, formacioneve paraushtarake apo parapolicore të huaj, grupe të organizuara apo individualisht jasht territorit të Republikës së Maqedonisë.

Të ndihmuarit e armikut

Konsiderohet ajo vepër penale ku qytetari i Republikës së Maqedonsië i cili gjatë kohës së luftës ndihmon armikun në zbatimin e rekuizimit, të marrjes së ushqimit apo të pasurisë tjetër apo në zbatimin e masave të tjera të dhunshme ndaj popullates.

Bashkimi për veprimtari armiqësore

Kete veper penale e kryen ai cili krijon komplot, grup, bandë apo organizatë per të kryer vepra penale nga nenet 305 e deri në 311, 313, 314, 315, 321 dhe 322 paragrafi 2.

Kryerësi i veprës nga paragrafi 1 i cili me zbulimin e shoqatës apo në menyrë tjetër do të pengojë kryerjen e veprave penale të parapara në paragrafin 1, do të dënohet me burgim prej 3 muaj deri në 3 vjet, por edhe mund të lirohet nga burgimi.

Pjesëtari i shoqatës nga paragrafi 1 cili do të zbuloj shoqatën para se të kryejë në përbërje të saj apo për të, ndonjë vepër penale të paraparë në atë paragraf, do të lirohet nga dënimi.

Pjesëtari i shoqatës nga paragrafi 1 i cili do ta zbulojë shoqatën para se të kryejë në përbërje të saj apo për të ndonjë vepër penale të paraparë në atë paragraf, do të lirohet nga dënimi. Sendet dhe mjetet e destinuar në përgaditjen e veprave, si dhe mjetet për financimin e shoqatës merren.

Fshehja dhe të ndihmuarit e kryerësit pas veprës së kryer penale

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

Kryhet në rastet kur personi do të fsheh kryerësin e veprës penale, do ti japë ushqim, do të strehojë, do ti jap para apo mjete të tjera apo të ndërmerr veprime tjera për të penguar zbulimin e zënies së tij ose kryerësi të ndihmohet në mënyra tjera.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në a) ofrimin e strehimit, ushqimit, parave dhe mjeteve të tjera b) mbajtjen e lidhjeve c) ndërmarrjen e veprimeve kah pengimi i zbulimi të tij dhe c) dhëniën e ndihmesës në mënyra të tjera.

Ndëshkimi për përgaditje

Vepra penale ndëshkimi për përgaditje njëherit është vepra e fundit penale kundër shtetit. Kryerësi i veprës penale konsiderohet se ka kryer vepër penale nëse ai përgadit kryerje të veprës penale nga nenet 309, 312, 313 dhe 314.

2. DISA NGA VEPRAT PENALE TË RENDIT PUBLIK QE RREZIKOJNË SIGURINË E R.M-SË

2.1 Emërtimet ligjore të veprave penale kundër rendit publik sipas kodit penal të RM-së

Disa forma të tjera të kriminalitetit që rrezikojnë sigurinë e Republikës së Maqedonisë, në kodin penal të vendit parashihen si vepra penale kundër rendit publik të parashikuara nga neni 382 deri në nenin 402 të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë. Mirëpo në këtë punim do të trajtojmë disa nga veprat penale që rrezikojnë sigurinë e qytetarëve të R.M-së. Këto vepra janë:

Dhuna

Ai i cili tjetrin e keqtrajton, e fyen vrazhdë, e rrezikon sigurinë e tij apo ndaj tij ushtron dhunë të vrazhdë e me këtë në publik shkakton ndjenjë pasigurie, rrezikim apo frikë, do të dënohet me burgim prej tre muaj deri në tre vjet-neni 386.¹²

Ai i cili me hedhjen e mjeteve apo sendeve piroteknike me të cilat mund të rrezikohet jeta apo trupi i tjetërkujt apo pasuria e objekteve në fusha sportive apo auditoriencë apo me hyrjen në fushë sportive me qëllim të shkaktojë dhunë fizike apo ndonjë dhunë tjetër, do të dënohet me burgim prej tre muaj deri në tre vjet.¹³

Ndryshimi i kundërligjshëm i ndarjes territoriale të Republikës së Maqedonisë

Kjo vepër penale parashihet në nenin 388 të KP të R.M-së. Kryerës i kësaj veprë penale është personi i cili me përdorimin e forcës, kërcënimit serioz apo ndonjë mënyre tjetër të kundërligjshme e ndryshon ndarjen territoriale të R.M-së, territor ky i përcaktuar me ligj.

Organizata terroriste

Ai i cili formon grup, bandë apo organizatë tjetër kriminale për kryerje të veprave penale të: vrasjes, lëndimit trupor, rrëmbimit të personave, shkatërrimit të objekteve publike, sistemeve transportuese, objekteve të infrastrukturës, sistemit të informimit dhe objekteve tjera për përdorim të përgjithshëm, rrëmbimit të aeroplanëve apo mjeteve të tjera për transport

¹² Osmani Afrim, Kodi Penal i R.M-së, Shkup, 2015, fq.319

¹³Po aty

publik, prodhimit, posedimit apo tregtisë me armë nukleare, armëve biologjike, kimike dhe llojeve të tjera të armëve dhe materieve të rrezikshme, lëshimit të substancave të rrezikshme radioactive, helmuese dhe substance tjera të rrezikshme apo shkaktimit të zjarrit apo eksplodimit, shkatërrimit të instalimeve për furnizim me ujë, energji apo të burimeve tjera themelore të rrezikshme, me qëllim të krijimit të ndjenjës së pasigurisë apo frikës te qytetarët apo për kërcënim të rendit kushtetues të vendit apo interesave të organizatës ndërkombëtare apo të shtetit të huaj.¹⁴

Terrorizmi

Neni 394-b parasheh veprën penale "terrorizmi". Kryerës i kësaj veprë penale është personi i cili do të kryej një apo më tepër vepra të vrasjes, lëndimit trupor, rrëmbimit të personave, shkatërrimit të objekteve publike, sistemeve transportuese, objekteve të infrastrukturës, sistemit të informimit dhe objekteve tjera për përdorim të përgjithshëm, rrëmbimit të aeroplanëve apo mjeteve të tjera për transport publik, prodhimit, posedimit apo tregtisë me armë nukleare, armëve biologjike, kimike dhe llojeve të tjera të armëve dhe materieve të rrezikshme, lëshimit të substancave të rrezikshme radioactive, helmuese dhe substance tjera të rrezikshme apo shkaktimit të zjarrit apo eksplodimit, shkatërrimit të instalimeve për furnizim me ujë, energji apo të burimeve tjera themelore të rrezikshme, me qëllim të krijimit të ndjenjës së pasigurisë apo frikës te qytetarët.

Financimi i terrorizmit

Personi i cili në mënyrë direkte apo indirekte, jep ose siguron para apo pasuri, me qëllim që ato të përdoren ose shfrytëzohen për të kryer këto vepra penale:

-VP "rrëmbim i fluturakes apo lundrueses"(neni 302 i KP);

-VP kërcënim terrorist i sigurisë së komunikacionit ajror (neni 303 i KP);

-VP kërcënim terrorist të rendit kushtetues dhe të sigurisë (neni 313 i KP);

-VP organizata terroriste (neni 394-a i KP);

¹⁴Osmani Afrim, Kodi Penal i R.M-së, Shkup, 2015, fq.324

-VP terrorizëm (neni 394-b) etj, me qëllim të krijojë ndjenjë të pasigurisë apo frikës te qytetarëve.

3. Trajtimi i veprës penale kundër shtetit dhe veprës penale kundër rendit publik sipas:

3.1 Kodit penal të RM-së;

Sic e cekëm me lartë, legjislacioni i R.M-së, u kushton një rëndësi të veçantë veprave penale kundër shtetit dhe veprave penale kundër rendit publik. Rëndësia në moskryerjen e veprave penale është faktorë kryesorë për mbrojtjen dhe avancimin e paqes, sigurisë, të jetës dhe shëndetit, të pronës dhe sigurisë personale të qytetarëve.

Kodi penal u miratua në mars të vitit 2004 me Ligjin për ndryshime dhe plotësim të Kodit penal të R.M-së

Intervenime më të mëdha janë bërë në kapitullin e veprave penale kundër shtetit. Mbrojtja penale-juridike e shtetit është kufizuar në ndëshkimin e veprimeve që kanë domethënien e ndryshimeve detyruese kundërshtuese të rregullimit shtetëror, me cka është tërhequr vijë e qartë e demarkacionit në mes lirisë së përcaktimit dhe veprimit politik dhe realizimi i qëllimeve politike në mënyrë jodemokratike. Me dispozitat e reja mbrohet vetë shteti dhe procedura kushtetuese e konsistimit të modelit të rregullimit shtetëror, politik dhe ekonomik, e jo model i caktuar.¹⁵

Kontributi i institucioneve më të larta të shtetit në avancimin e vlerave demokratike të shtetit, liritë dhe të drejtat e njeriut, sundimi i ligjit, pluralizmi politik, mbrojtja e identitetit kulturor, rruajtja dhe avancimi i funksionimit të demokracisë multietnike, përmisimi i marrëdhënieve etnike, zhvillimi social dhe ekonomik i R.M-së, politika mbrojtëse në integritet EURO-ATLANTIKE, si dhe bashkëpunimi me organizata të tjera ndërkombëtare, do të jenë pengesë kryesore për kryerjen e tyre, njëherit edhe hap i rëndësishëm për një jetë më të mirë të qytetarëve.

¹⁵ Afrim Osmani, Kodi Penal i R.M-së, Shkup, 2015, fq.27

Sigurisht që Kodi penal i R.M-së një rëndesi të veçantë u kushtoi edhe masave të cilat janë të parapara në këtë ligj, ndaj kryerësve të këtyre veprave penale për të vetmin qëllim, mbrojtjen e shoqërisë, stabilitetit, sigurisë nga kriminaliteti.

3.2 Kodit penal të Republikës së Shqipërisë

Veprat penale kundër shtetit në kodin penal të Republikës së Shqipërisë të vitit 1995, dhe ndryshimeve që pësoi në janar të vitit 2001, parashihen në kreun e pestë të pjesës së posaçme të kodit penal, të ndara në 2 seksione.

Seksioni i parë paraqet seksionin e krimeve kundër pavarësisë dhe integritetit.

Neni 208 parashef veprën penale Dorëzimi i territorit.

Neni 209 i KPRSH, parasheh veprën penale "Dorëzimi i forcave të armatosura", kurse neni 210 parashef veprën penale "marrëveshja për dorëzim territori". Në nenet në vazhdim radhiten edhe këto vepra penale:

-Provokimi i luftës-neni 211;

-Marrëveshja për ndërhyrje të armatosur-neni 212;

-Dhënia e informatave sekrete-neni 213;

-Sigurimi i informatave-neni 214;

-Dëmtimi i objekteve mbrojtëse-neni 215;

-Sigurimi i mjeteve për shkatërrimin e teknikës luftarake-neni 216;

-Marrja e shpërblimeve-neni 217;

-Vënia në shërbim të shteteve të huaja-neni 218;

Veprat penale kundër rendit kushtetues janë të parapara në seksionin e dytë të KPRSH, nga neni 219 e deri në nenin 225.

Ne nenin 219 parashihet vepra penale "Atentati", ndërsa në nenet në vazhdim do ti cekim veprat e tjera penale si:

-Komploti-neni 220;

-Kryengritja e armatosur-neni 221;

-Thirrjet për armatosje ose marrja pa të drejtë e komandës -neni 222;

-Thirrjet publike për veprime të dhunshme-neni 223;

-Krijimi i partive dhe shoqatave antikushtetuese-neni 224;

-Shpërndarja e shkrimeve antikushtetuese-neni 225.

Është shumë e rëndësishme të potencohet se terrorizmi si vepër penale kundër shtetit në bazë të legjislacionit të R.M-së, në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë është i radhitur në kreun e shtatë, te quajtur VEPRA ME QËLLIME TERRORISTE.

Klasifikimi i terrorizmit në disa vepra penale në KPRSH-së, është tregues i rëndësishëm se Republika e Shqipërisë lufton kundër kërcënimeve të mundshme në rajon e më gjërë, si dhe koordinimi i masave në parandalimin e goditjes në kohë të çdo veprimtarie terroriste është prioritet shtetëror.

3.3 Kodit penal të Republikës së Kosovës

Me qëllim të parandalimit dhe luftimit të formave të kriminalitetit, rruajtjes së stabilitetit dhe sigurisë në vend, një rëndësi mjaft e veçantë iu kushtua edhe veprave penale kundër rendit kushtetutes dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, të parapara në kapitullin e gjashtëmbëdhjetë të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, i miratuar më 20.04.2012.

Nga neni 121 deri në nenin 147 të KPRK radhiten këto vepra penale:

- Sulmi kundër rendit kushtetues të Republikës së Kosovës-neni 121;

-Kryengritja e armatosur- neni 122;

- Pranimi i kapitullimit dhe okupimit-neni 123;
- Tradhëtia ndaj vendit-neni 124;
- Rrezikimi i tërësisë territoriale-neni 125;
- Vrasja e përfaqësuesve të lartë të Republikës së Kosovës-neni 126;
- Rrëmbimi i përfaqësuesve të lartë të Republikës së Kosovës-neni 127;
- Dhuna ndaj përfaqësuesve të lartë të RK-neni 128;
- Rrezikimi i rendit kushtetues me shkatërrimin ose dëmtimin e instalimeve dhe paisjeve publike-neni 129;
- Sabotimi-neni 130;
- Spiunimi-neni 131;
- Zbulimi i informacioneve të klasifikuara dhe mosrruajtja e informacioneve të klasifikuara;
- Bashkimi për veprimtari kushtetuese;
- Përkufizimet për dispozitat e terrorizmit;
- Kryerja e veprës terroriste;
- Ndihma në kryerjen e terrorizmit;
- Lehtësimi për kryerjen e Terrorizmit;
- Rrekrutimi për terrorizëm;
- trajnimi për terrorizëm;
- shtytje për kryerjen e veprave terroriste;
- fshehja ose moslajmërimi i terroristëve dhe grupeve;
- organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist-Neni 144;

-Përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës- Neni 145;

-Parëndësia e kryerjes së veprës terroriste Neni 146;

-Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare –neni 147;

-Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik.

Në këtë kod u bënë plotësime të rëndësishme për penalizimin e fajtorëve që kryejnë vepra penale duke parashikuar dënime të larta, plotësime të cilat avancuan politikën e luftimit të kriminalitetit që të ngrihet në shkallën më të lartë kundër krimit.

KAPITULLI I TRETË

SANKSIONET PENALE TË VEPRAVE PENALE KUNDËR SHTETIT SIPAS KODIT PENAL TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

1. Sanksionet e shqiptuara kundër kryerësve të veprave penale kundër shtetit dhe veprave penale kundër rendit publik në gjykatat e R.M-së.

Sanksionet penale si masa të dhunshme penalo-juridike ndaj kryerësve të veprave penale me qëllim të mbrojtjes së shoqërisë dhe individit nga kriminaliteti, në legjislacionin e R.M-së, gjegjësisht në Kodin penal të R.M-së janë të potencuara për çdo vepër penale.

Duke filluar nga neni 305 i Kodit Penal, dënimet për veprat penale kundër shtetit janë paraparë si vijon:

-Në veprën penale “tradhëtia e madhe”, në nenin 305 të KP, sanksioni penal për kryerësin është dënim me më së paku 5 vjet burgim.

-Pranimi i pushtimit (okupimit) si vepër penale në nenin 306 të KP, qytetari i R.M-së që do ta kryej këtë vepër penale do të sanksionohet me dhjetë vjet burgim ose burgim të përjetshëm.

-Sipas nenit 307- Rrezikimi i tërësisë territoriale, paragrafit 1 masat e dënimit do të arrijnë në më së paku pesë vjet burgim, ndërsa në bazë të paragrafit të dytë ky dënim është më së paku katër vjet.

-Në nenin 308, në të cilin parashifet VP-Rrezikimi i pavarësisë, kryerësi i veprës penale do të dënohet me më së paku pesë vjet burgim.

-Vrasja e përfaqësuesve të organeve më të larta shtetërore në nenin 309, për kryerësin masa e dënimit do të arrijë deri në më së paku dhjetë vjet burgim ose burg i përjetshëm.

-Rrëmbimi i përfaqësuesve të organeve më të larta shtetërore si vepër penale, parashifet dënim në më së paku tre vjet burgim, sispas nenit 310 paragrafi i parë, kurse masa e dënimit në paragrafin e dytë është lirim nga dënimi.

-Masa e dënimit për veprën penale në bazë të nenit 311 ndaj kryerësit do të shqiptohet deri në më së paku 4 vjet.

-Kryengritja e armatosur si VP, në nenin 312, në paragrafin e parë, parasheh masën e dënimit në më së paku katër vjet burgim, kurse në paragrafin e dytë masa e dënimit është deri në më së paku pesë vjet burgim.

-Në nenin 313 i KP të R.M-së, masa e dënimit është më së paku dhjetë vjet burgim, kurse për veprën penale Diversioni të nenit 314, masa e dënimit arrijnë deri në më së paku 4 vjet burgim.

-Te Sabotimi dhe Spiunimi si vepra penale në nenet 315 dhe 316, për kryerësit e VP, parashihet dënim deri në më së paku 4 vjet burgim.Paragrafi i katërt dhe i pestë i VP spiunimi, parasheh dënim me më së paku dhjetë vjet burgim, ndërsa në paragrafi i pestë dënimi është në më së paku katër vjet burgim.

-Dhënia e sekretit shtetëror e nenit 317, për paragrafin e parë masa sanksionuese është prej një deri në dhjetë vjet, paragrafi i dytë prej një deri në pesë vjet, paragrafi i tretë deri në më së paku katër vjet burgim, ndërsa sipas paragrafit të katërt kryerësi do të dënohet prej pesë deri në gjashtë vjet burgim.

-Kodi penal për VP thirrja për ndryshim të dhunshëm të rendit kushtetues për kryerësin parasheh dënim prej tre muaj deri në pesë vjet burg.

-Në nenin 319 të KP, paragrafi i parë parasheh dënim prej një deri në pesë vjet burgim, ndërsa paragrafi i dytë parasheh dënim me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

-Cënimi i sovranitetit territorial si VP në kodin penal për kryerësin parasheh dënim prej një deri në pesë vjet burgim, kurse KP për veprën penale të nenit 321 paragrafi i parë parasheh dënim me më së paku katër vjet, ndërsa në paragrafin e dytë dënimi arrijnë në më së paku një vjet burgim.

-Neni 322 për veprën penale Shërbimi në ushtrinë e armikut në paragrafin e parë dënimi është në më së paku 3 vjet, ndërsa paragrafi i dytë dënimi arrijnë deri në më së paku katër vjet.

-Për nenin 322-a, masat sanksionuese arrijnë në më së paku katër dhe pesë vjet, për paragrafet 1, 2, 3, 4, 5, 6, ndërsa sipas paragrafit të shtatë kryerësi do të lirohet nga dënimi.

-Të ndihmuarit e armikut në nenin 323 të KP, kryerësi do të dënohet më së paku një vjet burgim.

-Bashkimi për veprimtari armiqësore në nenin 324, kryerësi sipas paragrafit të parë do të dënohet me më së paku katër vjet burgim, sipas paragrafit të dytë do të dënohet me burgim prej një deri pesë vjet, sipas paragrafit të tretë do të dënohet me burgim prej 3 muaj ose edhe mund të lirohet nga dënimi kurse sipas paragrafit të katërt do të lirohet nga dënimi.

-Në nenin 325 të KP, paragrafi i parë dënon kryerësin prej një deri në dhjetë vjet, ndërsa paragrafi i tretë parasheh që personi i cili me kryerësin e VP është në martesë apo ne bashkësi të përhershme jashtëmartesore, kushëri gjaku në vijë të drejtë, vëlla apo motër nuk do të dënohet.

-Për VP Ndëshkimi për përgaditje në nenin 326, masa sanksionuese është prej një deri në dhjetë vjet.

-Për veprën penale Ndëshkimi për format më të rënda të veprave penale në nenin 327, si vepër penale e fundit e këtij kapitulli, parasheh dënim në më së paku dhjetë vjet për paragrafin e parë kurse në më së paku dhjetë vjet ose burgim të përjetshëm në paragrafin e dytë të këtij neni.

-Për veprën penale Dhuna në nenin 386 të kodit penal, në paragrafin e parë dhe të dytë është paraparë për kryerësin e veprës penale prej tre muaj deri në tre vjet. Në paragrafet e tjera të kësaj vepre penale parashihet dënim me burg deri në dhjetë vjet.

-Për VP Ndryshimi i kundërligjshëm i ndarjes territoriale të R.M-së, neni 388 parasheh dënim me burg prej një deri në pesë vjet.

-Sanksionet për veprën penale të nenit 394-a, në paragrafin e parë kryerësi do të dënohet më së paku tetë vjet burgim kurse paragrafi i dytë parasheh dënim me burgim prej katër deri në dhjetë vjet. Paragrafi i katër dhe i pestë i kësaj vepre penale parasheh edhe lirim nga dënimi.

-Sanksionet për veprën penale Terrorizmi të nenit 394-b janë sanksione të cilat arrinë burgim prej dhjetë vjet deri në burgim të përjetshëm kurse paragrafi tjetër parasheh burgim më së paku tetë vjet.

-Financimi i terrorizmit të nenit 394-c, paragrafi i parë parasheh dënim me burgim në më së paku tetë vjet burgim, paragrafi i dytë dënim me burgim në më së paku katër vjet etj.

Në R.M-së që nga viti 1991, në bazë të hulumtimeve janë kryer disa vepra penale kundër shtetit, nëpërmjet të cilave është rrezikuar siguria dhe stabiliteti në vend.

Në tetor të viti 1993 është kryer vepër penale-Atentat ndaj kryetarit të atëhershëm të shtetit Kiro Gligorov i cili i mbijetoi këtij atentati me lëndime të rënda trupore.Në vendngjarje gjendet i vdekur shoferi i kryetarit të shtetit dhe i plagosur truproja e kryetarit.Gjithashtu nga lëndimet e mara më von vdes nje pensioniost i cili ishte kalimtar rasti në afërsi të vendit të ngjarjes.

Sulmi është kryer me bombë në rrugën Maqedonia, kur kryetari i shtetit me veturë zyrtare ka shkuar nga rezidenca e tij në Kuvend të Republikës së Maqedonisë.Bomba është vendosur në veturë AMI 8 e cila është aktivizuar kur vetura e kryetarit të shtetit ka kaluar pranë saj.

Rreth çështjes se kush qëndron pranë ktij atentati, edhe pse hetimi ka qenë i hapur nga ana e ministrisë së punëve të brendshme, të involvuar gjithashtu edhe forcat e sigurisë se Gjermanisë, SHBA dhe Anglisë, kryerësit ende nuk janë të njohur.

Në 7 nëntor të vitit 2007 ndodhi aksioni policor „Stuhia Malore” në fashtin Brodec të Tetovës, në të cilet u akuzuan 17 persona prej të cilëve 4 janë në arrati.Në këtë aksion policor, policia ka ndjekur një grup kriminelësh për të cilat kanë egzistuar dyshime se kanë ikur nga burgu i Dubravës në Kosovë.¹⁶

Policia gjatë këtij aksioni policor gjeti edhe sasi të madha të armëve, municionit dhe eksploziv.

Katër nga organizatorët gjenden në arrati kurse të akuzuarit të tjerë ishin fshatarë të fshatit Brodec.

¹⁶www.akademik.mk

Të akuzuarit janë gjykuar për veprime terroriste me qëllim të prishjes së rendit kushtetues.

Ky gjykim perfundon pas vuajtjes së dënimit të të burgosurve. Të akuzuar ishin: Hebib Ahmeti, i cili u dënua me 12 vjet burg, ndërsa 12 të akuzuarit e tjerë Nevzat Zyberi, Izmit Ameti, Mekdi Islami, Florim Ameti, Nevzat Arjani, Shehir Zyberi, Nadi Dauti, Bafkjar Bekiri, Tafil Dauti, Hanif Dervishi, Rametulla Dauti dhe Shkendim Dauti, të gjithë nga Brodeci,- u dënuan me nga 10 vjet heqje lirie.¹⁷

Një rast tjetër i cila kualifikohet si vepër penale është edhe rasti „Monstra“-vrasja e pesëfishtë që ndodhi më 12 prill të vitit 2012 në Liqenin e Smilkovës në Shkup.

Të akuzuarit janë gjykuar për veprën penale “Terrorizëm” të nenit 394 alinea 1.Motivi i kryerjes së vrasjes që trondit opinionin në bazë të prokurorisë është shkaktimi i frikës dhe pasigurisë te qytetarët.

Gjahtë të akuzuarit për këtë vepër penale u dënuan me burgim të përjetshëm.Në dhjetor të viti 2015 Gjygi i Apelacionit Shkup nga ankesat e Prokurorit Publik dhe Prokurorisë Themelore Publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korupcionit e përsëriti aktvendimin e Gjygit Themelor Shkupi 1.¹⁸

Lënda „ Monstra” u kthye në shqyrtim të sërishëm.Pezullimi i aktvendimit të shkallës së parë dhe të dytë dhe kthim të lëndës “Monstra” në vendosje të sërishme, kërkoi prokurorja publike Liljana Spasovska në senacë publike, në të cilën u shqyrtuan ankesat për burgim të përjetshëm, të cilën të gjykuarve ua shqiptoi Gjykata e Apelit, ndërsa i konfirmoi edhe Gjykata Supreme .

Një rast tjetër i kryerjes së veprës penale kundër shtetit konkretisht kryerjes së veprës penale Terorizem, është edhe rasti„Sopot” që daton nga viti 2003 kur në një makinë tereni në rajonin e Kumanovës jetën e humbën dy ushtarë polak të NATO-s dhe një shtetas i Maqedonisë si pasojë e një mjeti shpërthyes.Për ngjarjen u dënuan 11 persona nga fshati Sopot. Por, në një rën

¹⁷www.shenja.tv

¹⁸www.akademik.mk

nga bisedat e përgjuara të publikuara nga opozita në vitin 2015-të, u bë e qartë se aktgjykimi është miratuar pa dëshmi të forta.¹⁹

Në këtë rast 11 persona janë të dënuar për terrorizëm ku dënimi me burg arrin në 150 vjet.

Prokuroria themelore publike për ndjekje të krimit të organizuar dhe korupcionit në korrik të vitit 2017 lëndën Sopotin ja dorëzoi Prokurorisë speciale, nga moment që u publikuan bisedat e funksionerëve shtetërorë të lidhura me këtë. Më 9 shkurt në Gjykatën themelore Shkupi 1 filloi procesi gjyqësor kundër 29 personave pjesë e të ahtuquajturës „Grupi i Kumanovës” të cilët janë të akuzuar për terrorizëm dhe organizatë terroriste me ngjarjet endodhura me 9 dhe 10 maj në Lagjen e Trimave në Kumanovë.²⁰

Më shumë se dy vite pasi ndodhi përleshja e armatosur, Gjykata e Shkupit nxori vendim sipas të cilit gjeti fajtor 33 persona. Me burgim të përjetshëm u dënuan Andi Krasniqi, Dem Shehu, Fadil Fejzullahu, Nasuf Beqiri, Valdet Zekaj, Bek Bajramaj, Fejzulla Rushitovski. Me nga 40 vjet burg u dënuan, Sami Ukshini, Esat Kafexholli, Ardian Bujari, Shefqet Hallahi, Betim Kabashi, Bajrami Elshani, Nexhbedin Lika, Lirim Krasniqi, Sevdali Mustafi, Fatmir Reçica, Enver Hoxha, Rufki Dogani dhe Genc Sefaj. Me dënime nga 10 deri në 20 vjet burg u dënuan Qenan Iseni – 20 vjet burg, Fadil Elshani – 20 vjet burg, Lirim Demiri -20, Hajrush Abdija 20 vjet, Lendrit Rustemaj – 20 vjet, Mirsad Qerimi 20 vjet, Ragmi Latifi 18 vjet, Irafan Lutfiu- 14 vjet, Seadudin Abdullahi 13 vjet, ELham Arifi – 13 vjet burg, Musadik Pajaziti 12 vjet dhe Ebib Aliji 12 vjet burg.²¹

¹⁹www.alsat-m.tv,

²⁰www.akademik.mk

²¹ <https://kallxo.com/dosja-e-prokurorise-maqedone-per-grupin-e-kumanoves/>

KAPITULLI I KATËRT

INSTITUCIONET SHETËTORRE QË JANË PËRGJEGJËSE PËR SIGURINË E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

1. MINISTERIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Ministria e Punëve të Brendshme është institucion themelor i shtetit, qëllimi i së cilës është mbrojtja dhe garantimi i lirive dhe sigurisë të qytetarëve dhe respektimin e tërësishëm të të drejtave fundamenatle të njeriut dhe sundimit të ligjit.

Ministria e Brendshme, si organ i administratës shtetërore dhe ekzekutivit, është përgjegjëse për analizimin e sigurisë publike dhe shtetërore, në bazë të aktit të ri të sistematizimit të nëntorit të vitit 2013, duke punuar nën juridiksionin e drejtpërdrejtë të byrosë për siguri publike; rregjistri i bashkëpunimeve dhe sigurinë e informacionit të klasifikuar, i ngarkuar me zbatimin e aktiviteteve në kuadër të planit të veprimit për anëtarësim të Maqedonisë në hartën e Nato.²²

Plani i veprimit për anëtarësim, procesi është inicuar në Vashington, samiti në vitin 1999, për ta ndihmuar që të aspirojnë në gjetjen e problemeve të caktuara politike, ekonomike, karakter të sigurisë.²³

Arritja maksimale e efektit kundër kërcënimeve nga rethanat politike, ekonomike e sociale, paraqesin përgjegjësi për ministrinë si në nivel nacional poashtu edhe në nivel ndërkombëtar.

Sipas nenit 18 të ligjit për punë të brendshme ministria është kompetente për kryerjen e punëve të brendshme të parashikuara në nenin 2 të këtij ligji, si dhe kryerjen e punëve të tjera të parapara me ndonjë ligj tjetër.

²² www.mvr.gov.mk

²³ Po aty

Sipas nenit 2 të këtij ligji punë të brendshme janë:

- realizimi i sitemit të sigurisë shtetërore dhe publike;
- parandalimi i rënimit të dhunshëm të institucioneve demokratike të përcaktuara në kushtetutën e Republikës së Maqedonisë;
- mbrojtjen e jetës, sigurisë personale dhe pronës së qytetarëve;
- parandalimin e përkeqësimit të mosdurimit nacional, fetar dhe gjinor;
- parandalimin në kryerjen e veprave penale dhe kundërvajtjeve, zbulimin dhe kapjen e kryerësve të tyre dhe ndërmarrjen e masave të tjera me ligj për ndjekjen e kryerësve të veprave penale;
- punë qytetare;
- punë të tjera të përcaktuara me këtë ligj.²⁴

Gjithashtu ministria e punëve të brendshme është përgjegjëse nëpërmjet forcave policore të cilët duhet të jenë në shërbim të qytetarëve, për garantimin e sigurisë në vend.

Besimi në policinë e R.M-së me principe profesionale dhe standarde në drejtim të krijimit të njësisve mbrojtëse me eliminimin e arsyeve të paraqitjes së kriminalitetit dhe sjelljeve joshoqërrore në bashkpunim me të gjitha subjektet në vendin tonë të koordinuar me aktivitete mbi principin e partneritetit me policinë, me qëllim të përmisimit të kualitetit të jetesës të të gjithë qytetarëve.²⁵

Reforma policore është e drejtuar për të dhënë një model bashkëkohorë të organizimit të policisë, që u themelua mbi principin e qeverisjes të të drejtës dhe mbrojtjen respektimin e

²⁴Ligji për punë të brendshme, neni 2, Gazeta zyrtare e R.M-së nr.127/2016, Shkup

²⁵Fjalim në konferencën ndërkombëtare- Reformat në sektorin e sigurisë së R.M-së dhe ndikimi i tyre në luftën kundër kriminalitetit e mbajtur më 15.09.2012 në UEJL, fq.153

lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.²⁶Qëllimet themelore të vërtetuara në strategjinë për reformat e policisë janë:

- efikasitet në punët policore;
- organizim, profesionalizëm dhe ekonomik gjatë punës;
- përgaditje tekniko-teknologjike;
- përgjegjësi dhe motivim për të punësuarit;
- funksionimi i policisë në shërbim të qytetarëve.²⁷

Preventiva në R.M-së konsiderohet si themel në konceptin për bashkëpunim midis policisë dhe qytetarëve dhe ka një rol të rëndësishëm në arritjen e standardeve evropiane të punëve policore, kurse ministria për punë të brendshme është e obliguar që t'i realizoj reformat dhe të vendos strukturë adekuate që ka të bëjë me organizimin, mjetet dhe resurset njerëzore.²⁸

Implementimi i strategjisë për preventiv të punës policore duhet të rrjedh në kontinuitet me strategji, në nivel operativ dhe taktik në të cilën rolin kryesor e kanë udhëheqësit e njësive organizative dhe nëpunësve policor direkt të obliguar për implementimin e strategjisë për preventivë.²⁹

2. Organet e MPB-së

Strukturën organizative të Ministrisë së Punëve të Brendshme e përbëjnë:

- njësi organizative për nevojat e ministrisë
- organe në përbërje të ministrisë.³⁰

²⁶ Fjalim në konferencën ndërkombëtare- Reformat në sektorin e sigurisë së R.M-së dhe ndikimi i tyre në luftën kundër kriminalitetit e mbajtur më 15.09.2012 në UEJL, fq.43

²⁷ Po aty

²⁸ Fjalim në konferencën ndërkombëtare- Reformat në sektorin e sigurisë së R.M-së dhe ndikimi i tyre në luftën kundër kriminalitetit e mbajtur më 15.09.2012 në UEJL, fq.151

²⁹ Po aty

³⁰ Ligji për punë të brendshme, neni 15, Gazeta zyrtare e R.M-së nr.127/2016, Shkup

Neni 16 i këtij ligji parasheh kompetencat e njësive organizative për nevojat e ministrisë:

-Njësitet organizative për nevojat e ministrisë janë njësi organizative, kompetente për kryerjen e punëve profesionale në lidhje me kryerjen e punëve të brendshme për nevojat e të gjithë ministrisë.

Organet në përbërje të ministrisë janë Biroja për Siguri Publike dhe Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim.

2.1 Biroja për siguri publike

Neni 20 parasheh kompetencat e byrosë për siguri publike e cila kryen punët policore nën kushtet e parapara në ligjin për policinë dhe ligjet tjera. Me byronë udheheqë drejtori i cili emërohet dhe shkarkohet nga ana e qeverisë nën kushtet e përcaktuara me ligjin e policisë.

Byroja gjithashtu mund të formojë edhe grupe të tjera të veçanta për kryerjen e punëve në kompetencë të saj, gjithashtu edhe formimin e grupeve për kryerjen e punëve profesionale për nevojat e byrosë.

Në kompetencë të Byrosë për siguri publike janë:

-planifikimi konceptual, ndjekja dhe analizë e situatës së sigurisë dhe shkaqet e paraqitjes së kriminalitetit dhe rrezikimi i sigurisë publike;

-mbikqyrje e përgjithshme profesionale dhe kontroll mbi punën e njësive organizative të policisë;

-përpunimi i të dhënave personale nën kushtet dhe mënyrat e përcaktuara me këtë dhe ligj të vecantë;

-implementimi dhe ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare për bashkëpunim policor dhe akte të tjera ndërkombëtare për të cilat është përgjegjëse policia;

-kujdesi për gatishmërinë e policisë për veprim dhe punë në kushtet e ndërlikuara të sigurisë dhe punë të tjera të përcaktuara në ligj.³¹

Në kuadër të Byrosë për kryerjen e punëve policore janë të formuara disa njësi organizative:

-Sektori për punë policore nga kompetencat e veçanta dhe të përgjithshme;

-Sektori për punë në komunikacion;

-Sektori për policinë kriminalistike;

-Sektori për analizë dhe kundërzbulim kriminal;

-Sektori për punë kufitare dhe migracion;

-Sektori për punë të përbashkëta dhe udhëheqja me resurset njerëzore.

Në kornizë të Byrosë është formuar edhe Regjistri për bashkëpunim me Naton dhe siguria e informacioneve të klasifikuara, e cila kryen punët që kanë të bëjnë me implementimin e aktiviteteve në përputhje me Planin Aksionar për anëtarim të R.M-së në Nato dhe integrim në EU.

Zbulimi si proces për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave dhe informacioneve që janë të patjetërsueshme për mbrojtjen e interesave vitale të shtetit nga kërcënimet e brendshme dhe të jashtme, në botën bashkëkohore, vecanarisht sot, paraqet një nga funksionet vitale të shtetit.³² Shiqar historikisht, shefat e shteteve, qeveritë, udhëheqësit ushtarak kanë pasur nevojë që më herët ti ndjekin kërcënimet për shtetet e veta sepse pajisja me informacione ju mundëson zvogëlimin e painformimit dhe të sigurojnë bazë solide për prurjen e vendimeve të drejta.³³

³¹www.mvr.gov.mk-Të dhëna të Biros për siguri Publike

³² Fjalim në konferencën ndërkombëtare- Reformat në sektorin e sigurisë së R.M-së dhe ndikimi i tyre në luftën kundër kriminalitetit e mbajtur më 15.09.2012 në UEJL

³³Po aty

Në lidhje më kërcënimet e shumta të sigurisë, Biroja është përballur me forma të ndryshme të radikalizmit, terrorizmit, ekstremizimit dhe krimin të organizuar, të dhëna këto të publikuara nga Ministria për Punë të Brendshme, në raportin e vitit 2016.

Ky raport parasheh edhe çështjet që kanë të bëjnë me ngjarjet të drejtuara kah kërcënimet i sigurisë së shtetit. Janë të realizuara 6 vepra penale edhe atë:

-3 vepra penale "pjesëmarrje në luftë të huaj, polici, formacione para luftarake ose policore" për të cilët janë paraqitur 5 kryerës;

-2 vepra "terrorizëm" për të cilët janë lajmëruar 2 kryerës; dhe

-një vepër "organizim terrorist" për të cilët janë paraqitur 7 kryerës së veprës penale.³⁴

Gjithashtu Ministria e Punëve të Brendshme sipas këtij raporti, ka arritur që të shkatëroj një grup kriminel terrorist, 5 kryerësit penalisht përndiqen dhe të cilët kanë qenë pjesëtar të grupit të ashtuquajtur "shteti islamik". Ky grup ka kryer sulme në rethinën e Damaskut dhe në një bazë ushtarake në Siri dhe bazë ushtarake në qytetin Raka në Siri gjatë periudhës të muajit nëntor dhe dhjetor të vitit 2013.

2.2 Drejtoria për siguri dhe kundërzbulim

Në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si organ i veçantë që kryen punët në sistemin e sigurisë shtetërore, funksionon Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim.

Është e nevojshme të theksohet se janë dy kategori të ndryshme që nuk duhet të përzihen, sepse bëhet fjalë për definime të sakta funksionesh të mbrojtjes së brendshme dhe sigurisë (kundërzbulimi) dhe ndikimi dhe mbrojtja e interesave nga kërcënimet e jashtme (zbulimi).³⁵

Sistemin e sigurisë shtetërore e përbëjnë punët që kahnë të bëjnë me mbrojtjen nga spiunimi, terrorizmi ose aktivitete të tjera të drejtuara kah rrezikimi ose rrëzimi i institucioneve

³⁴www.mvr.gov.mk-Të dhëna zyrtare në raportin e vitit 2016 të Ministrisë së Punëve të Brendshme

³⁵ Fjalim në konferencën ndërkombëtare- Reformat në sektorin e sigurisë së R.M-së dhe ndikimi i tyre në luftën kundër kriminalitetit e mbajtur më 15.09.2012 në UEJL

demokratike të përcaktuara me Kushtetutën e R.M-së me përdorimin e forcës, si dhe mbrojtje nga format më të rënda të krimit të organizuar.

Kompetencat e kësaj drejtorie janë të parapara në nenin 23 të Ligjit për punë të brendshme.

Sipas paragrafit 1 të këtij neni:

-drejtoria është kompetente për kryerjen e punëve të brendshme lidhur me zbulimin dhe kundërzbulimin.

2. Siguria dhe kundërzbulimi, në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni, kanë të bëjnë me:

-aktivitetet e kundërzbulimit;

-kundërvënie dhe mbrojtje nga terrorizmi;

-mbrojtje nga aktivitete tjera të orientuara kah rrezikimi dhe rënimi me forcë të institucioneve demokratike të përcaktuara me kushtetutën e Republikës së Maqedonisë;

-format më të rënda të krimit të organizuar të cilët vijnë ose janë të orientuara kah institucionet demokratike të sistemit të përcaktuara në kushtetutën e Republikës së Maqedonisë dhe që mund të cojnë deri në rrezikimin ose të kenë ndikim në sigurinë e shtetit.³⁶

Kjo drejtori udhëhiqet nga drejtori i cili me kërkesë të ministrit emerohet dhe shkarkohet nga qeveria e Republikës së Maqedonisë me kohëzgjatje katërvjecare. Drejtori për punën e vet i përgjigjet ministrit dhe qeverisë së R.M-së.

Kjo drejtori ka të drejtë të mbledh informacione dhe të dhëna nga qytetarët me përdorimin e burimeve publike, të ketë qasje në regjistrin për të dhëna si dhe pranimi i mjeteve të posaçme dhe procedurat për mbledhjen e fshehtë të të dhënave në përputhje me ligjin. Gjithashtu drejtorja për siguri dhe kundërzbulim gjatë kryerjes së punës në kompetencë të saj ka të drejtë që nga organet e tjera shtetërore, ndërmarjet publike dhe subjekti juridik të kërkoj informacione, të cilët janë të obliguar të bashkëpunojnë me drejtorinë në dhënien e këtyre informacioneve.

³⁶Ligji për punë të brendshme, neni 23, Gazeta zyrtare e R.M-së nr.127/2016, Shkup

Sipas nenit 29 të ligjit për punë të brendshme;

-Drejtoria mund të mbledh të dhëna me përdorimin e bashkëpunorëve sekret.

-Bashkëpunimi me shtetas të R.M.-së dhe me të huaj krijohet me baza vullnetare dhe askush nuk guxon të jetë me forcë bashkëpunor i fshehtë i drejtorisë.³⁷

3. Ministria e Mbrojtjes

Ministria e mbrojtjes është institucion i rëndësishëm e cila sistemin e mbrojtjes e organizon si sistem për mbrojtjen e pavarësisë dhe integritetit territorial të shtetit. Disa nga kompetencat e ministrisë në Ligjin për mbrojtje janë të parapara në nenin 20 të këtij ligji.

Sipas tij Ministria e Mbrojtjes përgadit strategji për mbrojtjen e R.M.-së;

-bën vlersimin e kërcënimeve të mundshme ushtarake me të cilat çënohet sovraniteti, pavarësia dhe integriteti territorial i R.M.-së;

-organizon dhe përgadit sistem për mbrojtjen dhe propozon masa për zhvillim dhe përmisim;

-përgadit plan për mbrojtjen e R.M.-së;

-organizon dërgimin e urdhërave për realizimin e masave juridike dhe ndjek realizimin e tyre;

-organizon dhe kryen planifikimin e mbrojtjes;

-I planifikon nevojat e mbrojtjes dhe përpunon plane financiare dhe programe të nevojshme për mbrojtje;

-I shpërndan mjetet financiare për mbrojtje në përputhje me buxhetin e R.M.-së etj³⁸

Këto kompetenca në përputhje me kushtetutën e R.M.-së realizohen nëpërmjet Kuvendit të R.M.-së, Kryetarit të shtetit, Qeverisë dhe Ministrit të Mbrojtjes.

³⁷ Ligji për punë të brendshme, neni 29, Gazeta zyrtare nr.126/2017, Shkup

³⁸ Ligji i mbrojtjes, neni 20, Gazeta zyrtare nr.155, Shkup

Kuvendi i R.M-së bën mbikqyrjen në realizimin e kompetencave të qeverisë së mbrojtjes dhe ndjek gatishmërinë për mbrojtjen e R.M-së.

Gjithashtu Kuvendi në bazë të nenit 17 të Ligjit për mbrojtje, vërteton ekzistimin e kërcënimeve nga sulmet ndaj vendit, shpall gjendje të jashtzakonshme, jep përfundime dhe rezoluta në lidhje me realizimin e sistemit të mbrojtjes, bën planet për zhvillimin e mbrojtjes, ratifikon marrëveshje ndërkombëtare të cilat kanë të bëjnë me hyrjen, daljen, kalimin dhe qëndrimin e forcave të huaja të armatosura në territorin e R.M-së për aktivitete ushtarore, pjesëmarrje në operacionet paqëruajtëse humanitare si dhe të marrë pjesë në ato aktivitete nga pjesëtarët e Armatës së R.M-së në shtet tjetër, sjell përfundime dhe rezoluta në lidhje me realizimin e sistemit e mbrojtjes, planet për zhvillimin e mbrojtjes, raportet e të cilës i dërgon qeveria me kërkesë të Kuvendit në më se paku 2 vjet.

Kryetari i R.M-së është komandant suprem i Armatës. Për realizimin e mbrojtjes kryetari i shtetit bën strategji dhe plan për mbrojtjen e R.M-së, jep pëlqim për dokumentet për zhvillim të armatës.

Në bazë të nenit 18, Kryetari i R.M-së, sjell dokumente për nevojat e armatës dhe udhëzon përdorimin e tyre, bën organizimin dhe komandimin e armatës, udhëzon mobilizimin e armatës etj.

Për realizimin e funksioneve në fushën e mbrojtjes, Kryetari i R.M-së njëherit Komandant suprem i armatës sjell akte nënligjore.

Në kompetencë të qeverisë së R.M-së për realizimin e mbrojtjes së R.M-së, janë:

-proponon lartësinë e mjeteve për nevojat e mbrojtjes;

-jep mendim për strategjinë e mbrojtjes së R.M-së;

-vendos për hyrje dhe dalje të forcave të armatosura në shtete të huaja mbrenda dhe jashtë territorit të Republikës, qëndrimin dhe kalimin në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në ushtrime dhe aktiviteteve ushtarore, paqësore dhe operacione humanitare si dhe pranimin e të drejtës

në vetëmbrojtje individuale dhe kolektive, në përputhshmëri me marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare;

-vendos për vënien e obligimeve të punës;

-urdhëron përdorimin e policisë në gjendje lufte si përkrahje për armatën;

-vendos për aktivitete ushtarore të organeve të qeverisjes shtetërore, njësitë të vetqeverisjes lokale, shoqëritë tregtare, ndërmarrjeve publike.³⁹

Qeveria e R.M-së:

-proponon lartësinë e mjeteve për nevojat e qeverisë;

-në gjendje lufte proponon buxhet për R.M-së;

-jep mendim për strategjinë e mbrojtjes;

-vërteton propozimin e planit për mbrojtje të R.M-së;

-vendos për hyrjen dhe daljen e forcave të armatosura në shtetet e huaja mbrenda dhe jashtë territorit të R.M-së, qëndrimin dhe kalimin në lidhje me pjesëmarrjen në ushtrime dhe aktiviteteve ushtarore, operacione paqësore dhe humanitare në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare;

-vendos për pranimin dhe dhënien e ndihmës tekniko-ushtarake me vendet e tjera;

-vendos për vënien e obligimeve gjat punës;

-urdhëron për përdorimin e policisë në gjendje lufte si mbështetje për armatën etj.⁴⁰

4. Organet e Ministrisë së Mbrojtjes së RM-së

Në krye të kësaj ministrie gjendet Ministri i Mbrojtjes i cili udhëheq me ministrinë, Sekretari shtetëror, këshilltari shtetëror dhe Shefi i shtabit general.

³⁹ Ligji për mbrojtje, neni 19, Gazeta zyrtare nr.155, Shkup

⁴⁰Po aty

5. Roli i Ministrisë së Mbrojtjes në rruajtjen e stabilitetit dhe sigurisë

Politika nacionale në shtet bazohet në qëllimet themelore për rruajtjen e sigurisë dhe mbrojtjes së R.M-së, edhe atë në mbrojtjen e jetës dhe sigurisë personale të cdo qytetari të R.M-së, në garantimin e pavarësisë dhe integritetit territorial të shtetit, garantimi i lirive politike të qytetarëve si dhe të drejtat e tyre, posacërisht të drejta për religjion, si dhe të garantojë gjendje të mirë materiale dhe prosperitet të qytetarëve.

Për arritjen e këtyre qëllimeve, politika e mbrojtjes në shtet u përmbahet qëllimeve strategjike si integrimi politik dhe ekonomik në UE, integrimin luftarak në sistemet politike dhe të mbrojtjes-Organizata e Kombeve, OSBE dhe NATO, zhvillimin e sistemit shumëpartiak dhe institucioneve demokratike, zhvillimin e tregtisë ekonomike dhe në mirëmbajtjen e marrëdhënieve fqinjësore.⁴¹

6. Sfidat e Ministrisë së Mbrojtjes si garancion për qytetarët

Lufta kundër terrorizimit, arritja e të gjitha garancive për mbrojtjen e shtetit nëpërmjet politikës gjegjësisht integrimin në sistemet kolektive të mbrojtjes në NATO, pjesëmarrja aktive dhe bashkëpunimi për krijimin e arkitekture mbrojtëse evropiane të themeluara mbi NATO-n dhe OBSE, integrimi politik dhe ekonomik në Unionin Evropian, padyshim do të mbetet sfida kryesore e Ministrisë së Mbrojtjes për realizimin e tyre. Realizimi i sigurisë së përhershme dhe sigurisë drejt ndërtimit të mekanizmave demokratik dhe bashkëpunimit me shtetet tjera nëpërmjet Nato-s, për qytetarët do të thotë rritje të ekonomisë si dhe përmisim të standardit jetësor të tyre.

Për përmbushjen e këtyre qëllimeve strategjike, sistemi mbrojtës i R.M-së, është i rrumbullaksuar me organizimin luftarak dhe paqësor, me qëllime themelore për zhvillim, përgaditjen e forcave të armatosura si dhe kontrollën e plotë civile dhe menaxhimin me ato. Nga këtu, sistemi mbrojtës rrumbullakson të gjithë potencialin mbrojtës në vend:

⁴¹ <http://www.arm.mil.mk/baza/struktura/struktura.html>

qytetaret, organet shtetërore, forcat e armatosura, forcat e mbrojtjes , trupat e vetëqeverisjes lokale, institucionet publike dhe ndërmarjet me rëndësi të veçantë për mbrojtjen.⁴²

Kur flasim për "Reformat në sektorin e sigurisë" mendojmë për reformat që duhet realizohen në institucionet shtetërore kompetente për sigurinë e shtetit, me qëllim përfundimtar të fitohet shtet i sigurt dhe qeveri legjitime. Në këtë drejtim është e nevojshme të bëhet definimi i kërcënimeve bashkëkohore asimetrike pas të cilave do të bëhen reformat në sektorin e sigurisë.⁴³

Duke patur parasysh konsensusin politik të të gjitha subjekteve politike në R.M-së si dhe përkrahjen e qytetarëve të R.M-së për të luftuar terrorizimin, Maqedonia filloi rrugëtimin e saj për pjesëmarrjen në operacionet e njohura paqësore të njohur si operacioni ISAF.

R.M-së e filloi pjesëmarrjen e saj në NATO, në operacionin ISAF në gusht të vitit 2002.

Kjo pjesëmarrje e pjesëtarëve të armatës është në rritje dhe njëherit shumë e vlerësuar nga vendet anëtare të NATO-s. Si rezultat i kësaj, me qëllim të Rritjes dhe bashkëpunimit regional dhe interesave të përbashkëta për vënien e paqes në botë në kuadër të A-5 iniciativës (Shqipëri, Bosnje, Kroaci, Mali i Zi dhe Maqedoni) me ndihmën e SHBA dhe Sllovenisë filluan përgaditjet për pjesëmarrje në operacionin ISAF në misionin paqësor për trajnim në Afganistan.

Deri më tani Republika e Maqedonisë ka marrë pjesë me gjithsej 2169 ushtarë në operacionet paqësore ISAF.⁴⁴

Në përputhje me kompetencat ligjore Kuvendi i R.M-së, gjithashtu morri vendim për dërgimin e njërive të veta në misionin „Liri për Irakun” në periudhën prej vitit 2003 deri në dhjetor të vitit 2008.

Operacioni „ ALTEA” i nënshkruar me 3 korrik të vitit 2003 në Bruksel, si marrëveshje e arritur midis R.M-së dhe UE-së, cilësohet si të arriturat e para të shtetit të udhehequr nga UE-ja.

⁴² Po aty

⁴³ Fjalim në konferencën ndërkombëtare -Reformat në sektorin e sigurisë së R.M-së dhe ndikimi i tyre në luftën kundër kriminalitetit e mbajtur më 15.09.2012 në UEJL, fq.13

⁴⁴ <http://www.arm.mil.mk/baza/misii/isaf.pdf>

Gjatë viteve 2009, 2010 dhe 2011, Maqedonia ka qenë pjesëmarrëse e këtij operacioni me të njejtin kapacitet. Kurse në vitin 2012 pjesëmarrës ishin 11 uhshtarë të armatës së R.M-së. Kjo pjesëmarrje vazhdoi edhe në vitin 2013, me 11 pjesëtarë (10 pjesëtarë në ekipin mjekësor dhe një person ndihmës këshilltarë juridik në Zyrën Juridike të Komandës së EUFOR-it). Në bazë të përcaktimit të deklaruar për pjesëmarrje në grupe luftarake (GL) të BE-së, në gjysmën e dytë të vitit 2012, Republika e Maqedonisë merr pjesë në grupin luftarak BE LG II/2012, në të cilin merr pjesë Gjermania (vend lider), Austria, Çekia, Irlanda dhe Kroacia. Kontingjenti kombëtar numëron 150 persona personel ushtarak me këtë përbërje: një çetë e këmbësorisë, personel të shtabit në komandën e forcave, skuadër e përbashkët për MABK, ekip për zbulim, teknikë mjekësor në çetën mjekësore Nivel-1 dhe elementi kombëtar për mbështetje. Kontingjenti është në gatishmëri të plotë për shpërndarje gjatë gjysmës së dytë të vitit 2012, nëse për një gjë të këtillë do të ketë nevojë, si dhe të miratohen vendime përkatëse në nivel të BE-së dhe Kuvendit të Republikës së Maqedonisë (Ministerstvo za nadvorešni raboti 2013a).⁴⁵

⁴⁵ Rajkovceviski Rade, Ndërtimi i politikës së sigurisë, Rasti i R.M-së, Shkup, fq.162

KAPITULLI I PESTË

MEKANIZMAT JURIDIKË NË RM-së, TË CILAT GARANTOJNË SIGURI DHE STABILITET NË RM

DOKUMENTET STRATEGJIKE TË MIRATUARA PËR MBROJTJE DHE SIGURI TË RM-SË

1. Libri i Bardhë i Mbrojtjes

Libri i bardhë i mbrojtjes është një dokument publik i cili paraqet një cikël të ri të transformimit të sistemit të mbrojtjes në vend. Qëllimi i këtij dokumenti është paraqitja gjithëpërfshirëse e sigurisë dhe mbrojtjes së R.M-së, si dhe të riafirmoj interesat dhe vlerat e saja.

Libri i Bardhë prezantoi disa çështje kryesore që i referohen stabilitetit në vend, stabilitetit rajonal dhe global, duke theksuar përpjekjet aktuale dhe ato të ardhëshme për transformimin e mbrojtjes.

I miratuar në vitin 2012, Libri i bardhë riafirmon vlerat dhe interesat nacionale për realizimin e qëllimeve me prioritet, e veçanërisht atyre vlerave që kanë të bëjnë me qasjen sa më të shpejtë të antarësimit të plotë në NATO dhe Unionin Evropian.

Libri i Bardhë i Mbrojtjes, në përgjithësi, përfaqëson rezyme të të gjitha segmenteve të cilat e përbëjnë politikën nacionale të sigurisë dhe mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë:

-kontestin strategjik-qasjen gjithëpërfshirëse ndaj mbrojtjes dhe sigurisë

-aftësi për zbatimin e politikës në fushën e mbrojtjes, resurset dhe sfidat e ardhëshme.

Libri i Bardhë i Mbrojtjes, gjithashtu, përfaqëson rezyme të bazës ligjore nga e cila rezulton politika nacionale e sigurisë dhe mbrojtjes (Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Ligji për mbrojtje, Ligji për shërbim në Armatë), si dhe dokumentet kyç strategjike:

-Koncepti nacional për siguri dhe mbrojtje i vitit 2003;

-Strategjia për siguri nacionale e vitit 2008;

-Strategjia për mbrojtje e vitit 2010;

-Plani afatgjatë për zhvillimin e mbrojtjes: vitet 2011-2020.⁴⁶

Sa i përket politikës nacionale së sigurisë së mbrojtjes, sipas këtij dokumenti R.M-së sistemin e mbrojtjes e ka të organizuar në pjesëmarje aktive në forma të tjera të bashkpunimit ndërkombëtar të cilat i konsideron si mundësi për realizimin e interesave nacionale duke u deklaruar në përcaktimin e saj për qasje në NATO dhe UE.

Për përkrahjen e sigurisë nacionale, sistemi i mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë është i aftësuar për të përkrahur dhe përmbushur misionet vijuese strategjike:

-mbrojtje dhe ruajtje të integritetit territorial dhe pavarësisë së Republikës së Maqedonisë;

-pjesëmarje në mbrojtjen kolektive të NATO-s;

-kontribut në operacione në spektrin e gjërë të misioneve të OKB, NATO-s dhe BE-së;

-mbrojtje të interesave më të gjëra të Republikës së Maqedonisë.⁴⁷

Ky dokument gjithashtu parasheh edhe kompetencat institucionale për sigurinë dhe mbrojtjen nacionale dhe organizimin dhe misionet e armatës së R.M-së.

2. Strategjia e Mbrojtjes së R.M-së

Strategjia e mbrojtjes së R.M-së është një dokument publik i miratuar nga kryetari i R.M për funksionimin e mbrojtjes deri në vitin 2005.

Ky dokument definon misionet strategjike mbrojtëse për realizimin e tyre. Njëherit jep vizion për zhvillimin e aftësive të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Armatës së R.M dhe identifikon resurset e nevojshme për mirrëmbajtje dhe zhvillim të sistemit të mbrojtjes dhe siguron drejtime për integrim politik e ushtarak në Nato.

⁴⁶ Libri i Bardhe i Mbrojtjes, Shkup, shtator 2012, pika nr.6

⁴⁷ Libri i Bardhë i Mbrojtjes, Shkup, shtator 2012 pika nr.8

Strategjia e mbrojtjes së R.M si dokument publik do të sjellë mirrëmbajtjen e konsenzusit politik në shoqëri në lidhje me zhvillim të sistemit të mbrojtjes, vision për nevojat e ardhëshme të mbrojtjes dhe avansim të bashkpunimit ndërmjet subjekteve të sistemit të mbrojtjes.

Republika e Maqedonisë vendosi bashkpunim të gjërë në fushën e mbrojtjes në vend në Nato dhe Unionin Evropian nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në Partneritetin për Paqe, Procesin e planifikimit dhe kontrollimin e forcave, Planin aksionar për antarsim në Nato dhe në sigurinë Evropiane dhe politikën mbrojtëse.

Duke patur parasysh dimenzionet e kërcënimeve dhe rreziqeve bashkohore si pasojë e ndryshimeve dinamike dhe komplekse në botën bashkohore nga terrorizmi, krimi i organizuar kriminal, lufta e gjeneratës së katërt, radikalizmi dhe ekstremizimi fetar, migracionet ilegale, shtetet jostabile dhe jofunksionale dhe krimi kibernetik, qasja globale dhe bashkpunimi me OKB, NATO-N ,EU DHE OSBE, janë një instrument i domosdoshëm për kundërvënien ndaj të njejtëve. Këto janë faktorët kyç për mirrëmbajtjen dhe përfrocin e sigurisë, stabilitetit dhe prosperitetit regional.

Republika e Maqedonisë përballlet me kërcënimet dhe rreziqet të sigurisë kombëtare si:

- Terrorizmi, me të cilën përkeqësohet paqja, siguria, interesat e vendit dhe të botës;
- krimi i organizuar transnacional në të gjitha format;
- poliferimin e armëve për shkatrimin në masë e cila paraqet kërcënim në nivel global me pasoja shumë të mëdha;
- konfliktet regjionale;
- manifestime të nacionalizmit radikal dhe ekstremizimit;
- mospërmbajtja etnike dhe fetare;
- posedimi i sasive të mëdha të armëve jolegale dhe armatim të lehtë dhe municion;
- krimi kompjuterik;
- aktivitete të palejuara nga shërbimet e huaja sekrete;
- epidemi;
- degradim dhe shkatërrim të mjedisit jetësor dhe potencialeve ekonomike;
- problemet e brendshme social-ekonomike, krimi ekonomik, varfëria dhe papunësia.

Në bazë të këtij dokumenti për zhvillimin e sistemit të mbrojtjes, Republika e Maqedonisë do të mirrëmbajë bashkpunim regjional dhe ndërkombëtar mbrojtës në bashkpunim me vendet anëtare të OKB, NATO, EU dhe OSBE, me qëllim të ndërtimit të besimit dhe sigurisë në regjion në lëmin euro-atlantik, për sigurimin e mbështetjes diplomatike-ushtarake të partnerëve, për pjesëmarrje në ushtrime luftarake, konferenca dhe bashkpunime në forma të ndryshme etj.

Zhvillimi i sistemit të mbrojtjes organizohet si sistem i mbrojtjes dhe rruajtjes së integritetit shtetërorë, pavarësisë territoriale të shtetit si qëllim i përhershëm i vendit.

Në përkrahje të sigurisë nacionale, sistemi i mbrojtjes i R.M. i definon këto misionet strategjike:

- mbrojtjen dhe rruajtjen e integritetit teritorial dhe pavarësisë së Republikës së Maqedonisë;
- pjesëmarrja në mbrojtje kolektive në Nato;
- përfitimet në operacionet në spektrin gjithpërfshirës në misionet e Natos, OKB, OSBR dhe EU;
- rruajtjen e interesave me të gjëra të Republikës së Maqedonisë.⁴⁸

3. Marrëveshja Kornizë e Ohrit

Marrëveshja Kornizë e Ohrit u nënshkrua me 13 gusht të vitit 2001 me ndërmjetësimin e bashkësisë ndërkombëtare, si arritje nga konflikti i armatosur dhe njëherit edhe si mundësia e vetme për ndërprerjen e konfliktit të armatosur shtatë mujor në Maqedoni.

Qëllimi kryesor i hartimit të kësaj marrëveshje ishte realizimi i kërkesave të shqiptarëve në Maqedoni, kërkesa këto të cilat fillimisht u hartuan me Marrëveshjen e Prizrenit, me çrast gjithsesi duhej të ruhej karakteri unitar i shtetit.

Ndërprerja e armiqësive përkatesisht ndërprerja e dhunës për arritjen e qëllimeve politike, rruajtja e sovranitetit dhe integritetit teritorial të R.M-së dhe karakteri multietnik i shtetit ishin qëllimet parësore të kësaj marrëveshje.

Me këtë marrëveshje janë përcaktuar parimet themelore:

⁴⁸ Strategjia e mbrojtjes, Gazeta zyrtare nr.30, Misionet strategjike, fq.4

-Tërësisht dhe pakusht të hidhet poshtë përdorimi i dhunës, si mjet për realizimin e qëllimeve politike;

-konfirmimi i pacënueshmërisë së sovranitetit, integritetit territorial dhe karakterit unitar të shtetit, si dhe të mos ketë zgjidhje territoriale për çështjet etnike;

-ballafaqimi i karakterit multietnik i shoqërisë maqedonase dhe gjithësi pasqyrimi i saj përkatës në jetën publike;

-sigurimi i të drejtave të garantuara me Kushtetutë gjatë përmbushjes së plotë të nevojave të të gjithë qytetarëve, në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare;

-zhvillimi i vetadministrimit lokal, me qëllim të nxitjes dhe pjesëmarjes së qytetarëve në jetën demokratike dhe avancimi i identitetit të bashkësive.⁴⁹

Përveç dispozitave të parapara si ndërprerja e armiqësive, zhvillimi i pushtetit të decentralizuar mosdiskriminimi dhe përfaqësimi i drejtë, procedura të vecanta parlamentare, arsimit dhe përdorimi i gjuhëve, shprehja e identitetit, implementimi i Marrëveshjes së Ohrit dhe anekset dhe dispozitat kalimtare përfundimtare, kjo marrëveshje përbëhet nga tre ankese kryesore:

-Aneksi "A": Amendamente kushtetuese;

-Aneksi "B": Ndryshime të legjisllacionit; dhe

-Aneksi "C": Implementimi dhe masat e ndërtimit të mirëbesimit.

Në dispozitat e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit u përcaktua numri i ligjeve që do të modifikohen dhe në këtë drejtim u arrit marrëveshje për miratimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të tyre si:

-Ligji për vetadministrimin lokal;

-Ligji për financimin lokal;

-Ligji i kufijve komunal;

-Ligje që kanë të bëjnë me policinë e vendosur nëpër komuna;

-Ligji për shërbimin civil dhe administratën publike;

- Ligji për njësitë zgjedhore;

⁴⁹ Marrëveshja Kornizë e Ohrit

-Rregullorja e punës së Kuvendit;

-Ligje që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve; dhe

-Ligjin për Avokatin e Popullit.

Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje, filluan edhe reformat e para në sistemin juridik të Maqedonisë.

Në bazë të kësaj Marrëveshje dolën një numër i konsiderueshëm i ndryshimeve Kushtetuese dhe reforma ligjore të cilat duhet të zbatohen nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në sferën e decentralizimit, përfaqësimit të drejtë, procedurave speciale parlamentare për mbrojtjen e etniteteve që nuk janë shumicë, arsimimin, përdorimin e gjuhës, simbolet, shprehja e identitetit kulturor dhe etnik si dhe masat për zbatim e këtyre ndryshimeve.⁵⁰

Fillimisht preambula zavendësohet duke u bazuar në konceptin e të drejtave individuale të qytetarëve, ku Maqedonia konstituohet si shtet i pavarur, sovran, me qëllim të aplikimit dhe forcimit të sundimit të së drejtës, të sigurohet bashkëjetesa, drejtësia sociale, mirëqenia ekonomike si dhe garantimi i lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

Gjithashtu, njëra nga dispozitat kryesore të Marrëveshjes që pati ndryshime në legjislacion për zbatimin e procesit reformues, është dispozita ku përcaktohet parimi i mosdiskriminimit dhe realizimit të përfaqësimit të drejtë të bashkësive në administratën publike në nivel qendror dhe lokal, në polici, ushtri, ndërmarjet publike.

Mirëpo ka shumë dilema të ndryshme reth çështjes së implementimit të kësaj marrëveshje, edhe pas shumë vitesh nga nënshkrimi i të së njejtës.

Kjo dilemë ka të bëjë me faktin se edhe pse kanë kaluar shumë vite nga nënshkrimi, ky dokument ende nuk i ka të mbyllura pyetjet reth zyrtarizimit të gjuhës shqipe, përfaqësim të drejtë dhe adekuat të shqiptarëve nëpër institucionet shtetërore dhe mirëkuptim ndërmjet bashkësive.

⁵⁰ www.siofa.gov.mk

Kjo marrëveshje duhet të simbolizojë bashkpunim dhe zhvillim të përbashkët të bashkësive në Maqedoni, e kjo arihet nëpërmjet reformave rrënjësore nëpër institucione por edhe të mentalitetit në përgjithësi.

Dilema tjetër ka të bëjë me çështjen se, prej nënshkrimit të kësaj marrëveshje dhe së këndejmi a është respektuar ekuilibri ekonomik, sa nga projektet e zhvillimit regional janë realizuar.

Është më se evidente se në rajonet ku ka shumica i takojnë përkatësisë shqiptare në krahasim me rajonet ku shumica i përkasin etnitetit maqedonas kanë dallim të madh në numrin e të punësuarve, investimeve kapitale dhe në përqindjen e investimeve në zhvillimin rajonal e të tjera.

Sipas analistit Arsim Sinanit, në një intervistë të dhënë, thekson së për realizimin e tërësishëm të marrëveshjes është i nevojshëm vullneti politik i palës maqedone. Shumë çështje të rëndësishme sipas tij janë ende të paprekura si:

-socializimi i pjesëtarëve të mëparshëm të UCK-së të trajtohen në të njejtën mënyrë si trajtohen pjesëtarët e mëparshëm të forcave të sigurisë së Maqedonisë;

-gjuha shqipe e cila duhej të jetë gjuhë zyrtare siç është gjuha maqedone, e mos të quhet gjuhë e 20 %.

Ky implementim sipas tij duhet të fillojë nga Muzeu në shtëpinë e „Nënë Terezës” ku duhet të vendoset administratë shqiptare, të përdoret gjuha shqipe dhe të përdoret simbol ndërmjet palës shqiptare dhe palës maqedone.

Kryetari i mëparshëm i kuvendit të R.M-së thekson se mos implementimi i Marrëveshjes së Ohrit është shkelje e kushtetutës në vend.

Pjesmarësi në bisedimet për Marrëveshjen e Ohrit, Azis Pollozhani thekson se implementimi është një proces që nuk duhet të përshpejtohet dhe të jetë në përputhshmëri me pritshmëritë e qytetarëve dhe se ky dokument patjetër të implementohet sepse është dokument i njohur ndërkombëtarisht, sepse ka garantuar paqe kurse tani garanton stabilitet.

Zbatimi i plotë dhe efikas i Marrëveshjes kornizë të Ohrit si dhe garantimi i stabilitetit të vendit nëpërmjet promovimit dhe zhvillimit të një shoqërie paqësore dhe harmonike, duke respektuar identitetin etnik dhe interesat e të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë. Zbatimi i Marrëveshjes kornizë është me rëndësi të madhe për vazhdimin, avancimin dhe finalizimin e suksesshëm të procesit të integritit të Republikës së Maqedonisë në strukturat euratlantike.⁵¹

4. Koncepti nacional për siguri dhe mbrojtje

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me 11 qershor të vitit 2003 miratoi Konceptin kombëtar për siguri dhe mbrojtje.

Koncepti kombëtar për siguri dhe mbrojtje është dokument themelor i R.M-së në lëmin e mbrojtjes dhe sigurisë, rrënjët e së cilës janë në vlerat themelore nacionale, rrespektimi i Kushtetutës së R.M-së dhe ligjeve, barazia e të gjithë qytetarëve të R.M-së pa dallime etnike, themelimit demokratik të shtetit, sundimi i të drejtës, rrespektimi i të drejtave themelore dhe lirive të njeriut, tregtia ekonomike, drejtësi sociale dhe rrespektimin e të drejtës ndërkombëtare dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.

Interesat e R.M-së dalin nga vlerat me të larta themelore me Kushtetutën e R.M.-së në të cilët bëjnë pjesë:

-liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe qytetarit, shprehja e lirë e përkatësisë nacionale, demokracia, sundimi i të drejtës dhe rrespektimi i pranimit të normave ndërkombëtare.

-integrimi i përfaqësimit të drejtë të qytetarëve të cilët u përkasin të gjitha bashkësive në organet e qeverisjes shtetërore dhe institucioneve të tjera publike në të gjitha nivelet;

-mbrojtja e pronësisë, tregëtia e lirë, humanizmi, drejtësia sociale dhe solidariteti;

-garantimi, avansimi dhe zhvillimi i vetqeverisjes lokale dhe

-mbrojtje dhe avansimi i mjedisit jetësor.

⁵¹www.siofa.gov.mk

Në këtë koncept, instrumentet për realizimin e politikës nacionale të mbrojtjes janë të grupuara në politikën ekonomike, mbrojtëse të jashtme, politikën e mbrendëshme të mbrojtjes dhe politikën e mbrojtjes së mjedisit jetësor.

Politika e jashtme është e drejtuar në mbrojtje, mirëmbajtjes dhe avansimin e interesave të R.M-së në marrëdhënie me shtetet e jashtme.⁵²

Prioritet për politikën e jashtme padyshim është ndërtimi i marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe pjesëmarrja aktive në bashkpunimet regjionale dhe në vazhdimësi angazhimi në thellësimin e marrëdhënieve për krijimin e sigurisë në kuadër të OKB dhe OSBE si dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

R.M-së në bazë të këtij koncepti shfaq gadishmëri për bashkpunim, vënien në dispozicion të të gjitha kapaciteteve dhe pranimin e të gjitha masave dhe procedurave për eliminimin e rreziqeve transnacionale para se gjithash kundër terrorizmit, krimit të organizuar, migrimit ilegal dhe të llojeve të tjera të tregtisë ilegale.

Siguria dhe stabiliteti në vend janë në varësi të ngushtë me gjendjen ekonomike në vend.

Në këtë aspekt është me rëndësi të veçant zhvillimi dhe mirëmbajtja e makroekonomisë, zhvillimi i mekanizmave për hyrjen e kapitalit të huaj, rritja permanente e prodhimit, exportit, punësimi dhe standardi jetësor i qytetarëve, të cilët ndikojnë në zhvillimin e vendit dhe përmisimin e sigurisë në përgjithësi.

Avansimi i mëtutjeshëm i marrëdhënieve ekonomike në përputhshmëri me pranimin e masave aktive për bashkpunim me EU, Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore si dhe antarësimi i R.M-së në Organizatën tregëtare botërore është një interes themelor i vendit.

Politika për siguri të mbrendshme është e drejtuar në rruajtjen dhe avansimin e interesave të R.M-së që kanë të bëjnë me zgjidhjen e rreziqeve dhe kërcënimeve në lidhje me mbrojtjen e sistemit demokratik të përcaktuara me Kushtetutën e R.M-së.

⁵²Koncepti nacional për siguri dhe mbrojtje, Gazeta zyrtare nr.42/2001 dhe 5/2003, Politika e jashtme, fq.8

Veprimi i domosdoshëm i pushtetit ligjvënës dhe ekzekutiv në këto lëmi si Sundmi i të drejtës në të gjithë territorin e R.M-së, ndalimi dhe largimi i të gjitha reziqeve të cilët prishin të drejtën e përdorimit të pronës të qytetarëve të R.M-së, masa dhe aktivitetet për zhvillim të metutjeshëm të sistemit të pavarur gjyqësor, integrimi i shoqërisë, lufta kundër terrorizimit, krimit të organizuar, tregëtia jolegale me drogë, arme, etj, janë interes parësor në realizimin e politikës dhe sigurisë së brendshme në avansimin e proceseve demokratike dhe në ndërtimin e shtetit të së drejtës me qëllim të avansimit të nivelit të besimit të qytetarëve për institucionet e shtetit.

5. Plani afatgjatë për zhvillimin e mbrojtjes për periudhen kohore 2011-2020

Si akt i parë për implementimin e Strategjisë së mbrojtjes u miratua plani afatgjatë për zhvillimin e mbrojtjes për periudhen kohore 2011-2020, në mars të vitit 2010 dhe në fillim të viti 2011.

Ky plan përcakton aktivitetet kryesore për përforcimin e kapaciteteve institucionale të Ministrisë së Mbrojtjes dhe për zhvillimin e aftësive ushtarake të Armatës së R.M.

Plani siguron unitet të angazhimeve të ministrisë për zhvillimin sistematik të mbrojtjes dhe harmonizimin e resurseve të limituara me prioritetet kryesore zhvillimore.

Plani afatgjatë për zhvillimin e mbrojtjes 2011-2020 është plani themelor i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, i cili përmban vizionin për zhvillimin e mbrojtjes, prioritetet për realizimin e politikës në fushën e mbrojtjes, buxhetin për mbrojtjen-të nevojshëm për realizimin e prioriteteve të vendosura dhe qëllimeve zhvillimore afatgjate në drejtim të përforcimit dhe avancimit të aftësive të Armatës dhe kapaciteteve të Ministrisë së Mbrojtjes. Ai përfaqëson aplikim të menaxhimit bashkëkohor i cili do të bazohet në parimet e qeverisjes dhe planifikimit të mirë, në aftësitë operative të ARM-së dhe në misionet strategjike.

Qëllimet afatgjate strategjike janë:

-avancimi i sistematizimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe formacionit të ARM-së në funksion të përkrahjes së misioneve dhe obligimeve nga Strategjia mbrojtjen dhe transformimin e ARM-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes në organizata efektive, efikase dhe funksionale, të gatshme për t'uballafaquar me sfidat e shekullit 21;

- zhvillimi, arritja dhe vendosja e kapaciteteve dhe aftësive me të mëdha nacionale strategjike dhe operative për arritjen e nivelit të caktuar të operimit të ndërsjellë, efikasitetit, efektivitetit dhe fleksibilitetit me NATO-n, forcat e armatosura rajonale dhe ato të shteteve – partnere;
- modernizimi i aftësive mbrojtëse për komandim, kontroll, komunikime, kompjuterë dhe zbulim;
- transformimi i sistemit për menaxhimin e resurseve njërezore me qëllim që të rekrutohet, mbahet dhe përkrahet personel i kualitetit të lartë dhe i dedikuar ushtarak dhe civil;
- avancimi i sistemit për logjistikë;
- integrimi në strukturat politike dhe ushtarake të NATO-s;
- kontributi ndaj politikës së përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes së BE;
- adaptimi dhe përmisimi i trajnimit me qëllim që të përmbushen misionet, qëllimet dhe detyrat e ARM-së;
- përmisimi i infrastrukturës mbrojtëse.

6. Roli i organizatave ndërkombëtare

Paraqet një qasje relativisht të re në shfrytëzimin e kapaciteteve të sigurisë. Qasja është inkorporuar në politikën e mbrojtjes dhe në politikën e jashtme të sigurisë së Republikës së Maqedonisë. Pjesëmarrja në organizatat ndërkombëtare dhe në misionet strategjike të mbrojtjes, si pjesë të politikës së mbrojtjes, e përcaktuar në Strategjinë e Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë (pika 3 nga Kapitulli IV. Zhvillimi i sistemit të mbrojtjes i përfshirë në Strategjinë e mbrojtjes), në përgjithësi parashikon:

- Zhvillimin e aftësive për mbrojtjen e vendit;
- Avancimin e mekanizmave të kontrollit demokratik dhe civil mbi ARM dhe përdorimin e saj në funksion të qëllimeve të politikës së jashtme;

- Zhvillimin e kapacitetit të MM për menaxhimin efikas me resurset dhe proceset e mbrojtjes;
- mbindërtimin, zhvillimin dhe ruajtjen e aftësive ushtarakë të ARM-së;
- integrimin në strukturën politike, mbrojtëse dhe ushtarake të NATO-s;
- përfshirjen dhe kontributin në politikën evropiane të sigurisë dhe mbrojtjes;
- kontributin e vazhdueshëm në operacionet ndërkombëtare për mbështetjen e paqes dhe sigurisë.⁵³

7. Vetëorganizimi i shoqërisë civile

Shoqëria civile duhet të jetë aktive në ngritjen e disa shqetësimeve apo çështjeve. Këto shoqëri duhet ngritur shqetësimet e publikut duke pasur parasysh faktin që numri më i madh i këtyre çështjeve nuk realizohen nga institucionet publike. Presioni që duhet ta bëjë shoqëria civile duhet të jetë i madh, për të ndryshuar situatën ose qoftë si lloj presioni për të filluar procedurat për të ndryshuar gjendjen në shumë fusha.

Veçanarisht këto shoqëri i karakterizon unifikimi i kërkesave të tyre nga një grup i organizatve të shoqërisë civile me qëllim që të meren në konsideratë kërkesat e tyre.

Vetorganizimi i sigurisë së shoqërisë civile nënkupton organizim spontan por megjithatë të organizuar mirë dhe të orientuar si vetorganizim dhe veprim të sigurisë dhe mbrojtjes së individëve, por edhe të formave dhe shkalleve të ndryshme të vëtoorganizimit të sigurisë të grupeve shoqërore (grupe interesi, bashkësi lokale në nivel të vetëqeverisjes lokale), vetorganizim i sigurisë të individëve dhe grupeve shoqërore në çdo kohë, në çdo vend dhe në të gjitha nivelet e shoqërisë si digë për mbrojtje nga të gjitha format e rrezikut, fillimisht të sigurisë së tyre individuale (njerëzore) (Kotovčevski 2012: 33).⁵⁴

Në raste të caktuara për arsye se qëndrimet e unifikuara të shoqërisë civile nuk meren në konsideratë nga institucionet shtetërore është një arsye e madhe pse shoqëria civile nuk e luan rolin e saj.

⁵³Rajkovcevski Rade, Ndërtimi i politikës së sigurisë, Rasti i R.M, Shkup, fq.166

⁵⁴Rajkovcevski Rade, Ndërtimi i politikës së sigurisë, Rasti i R.M, Shkup, fq.165

Ka raste ku roli i tyre është më aktiv ne rrjetet sociale për ngritjen e shqetësimeve të qytetarëve. Mirëpo edhe kjo formë nuk ka sjellë dobi në përmisimin e disa nga problemet e qytetarëve.

KAPITULLI I GJASHTË

ANALIZË E SITUATËS AKTUALE NË RM

1. Ballafaqimi i RM-së me problemet e jashtme të shtetit

Si një ndër shtyllat kryesore të politikës së sigurisë përdyshim është edhe politika e jashtme e R.M-së.

Kjo politikë është e orientuar në mbrojtjen e vendit, rruajtjes dhe avancimit të interesave të R.M-së në marrëdhënie me shtete tjera dhe me organizatat ndërkombëtare.

Sigurisht që interes parrësor i vendit janë marrëdhëniet e mira fqinjësore, si një tregues kryesor i stabilitetit në Ballkan, mirëpo këto marrëdhënie janë më komplekset në Evropë. Me zhvillimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore mund të garantohet siguria e përbashkët dhe prosperitet.

Marrëdhëniet e jashtme të R.M me shtetet fqinje, Greqi, Bullgari, Shqipëri dhe Kosovë nuk kanë qenë në nivelin e duhur, që len të kuptohet se zanafilla e këtyre problemeve daton pas pavarësisë së Maqedonisë.

Problemi gati dy dekadësh i Maqedonisë dhe Greqisë vazhdon të jetë, bllokada kryesore për integrimin në BE. Çështja e emrit për të cilën Greqia, për shkak të një territori në veri të saj të quajtur Maqedoni nuk e njeh Republikën e Maqedonisë me këtë emër por me shkurtësën FYROM apo referencën Republika ish-Jugosllave e Maqedonisë edhe më tutje vazhdon të jetë një sfidë ku shteti duhet të gjejë mënyrë për zgjidhjen e këtij kontesti. Në fund të viti 2012 dhe në fillim të viti 2013 Greqia dhe Bullgaria bashkërisht e bllokuan fillim e negociatave të Maqedonisë me Bashkimin Evropian.

Bullgaria nuk e njeh identitetin e popullit maqedonas dhe minoritetin maqedonas që jeton në Bullgari, andaj ky problem paraqet një qetër shqetësim për bllokimin e proceseve euro-atlantike.

Pas shumë përpjekjeve të R.M-së për përmisimin e raporteve fqinjësore me Bullgarinë, rezultoi marrëveshja bilaterale midis 2 vendeve e njohur si Marrëveshja për fqinjësi të mirë dhe bashkpunim, e cila do të përforcojë rolin dhe pozitën e Maqedonisë në rajon dhe në Evropë.

Sipas kësaj marrëveshje, qeveria e bullgarisë afirmon gjuhen, kombin dhe identitein maqedonas.

Me këtë marrëveshje hapen prespektiva të reja për raporte të reja, për raporte të mira fqinjësore, si dhe përshejtim të procesit të eurointegrit.

Gjithashtu kjo marrëveshje parashef lehtësime tregëtare, doganore dhe rritje të shkëmbimit tregtar deri në 1 miliard euro.

Një përkeqësim i marrëdhënieve fqinjësore Maqedonia ka edhe me Sërbinë, të cilat u përkeqësuan me njohjen e pavarësisë së Kosovës nga Maqedonia, me çrast Sërbia tërhoqi diplomatët sërb nga Ambasada, duke kërkuar që Maqedonia të ndryshojë qëndrimin për Kosovën reth antarsimit të saj për pranimin në Unesco, duke u kercënuar se Sërbia nuk do ta njoh Maqedoninë me emrin kushtetues.

Reth kësaj çështje qeveria e R.M-së doli hapur me deklarata se do të zhvillojë marrëdhënie miqësore me të gjithë fqinjët e saj. Ndaj çështjeve të hapura dhe sensitive ndërmjet dy fqinjëve R.M-së gjithmonë do ti ndjek interesat e shtetit ndaj parimeve të fqinjësisë së mirë të bashkëpunimit rajonal dhe mospërzierjen në kontestet në mes shteteve.

Raportet fqinjësore me Kosovën dhe Shqipërinë, Maqedonia ka bërë përpjekje për përmisim. Kjo shifet qartë në marrëveshjen e nënshkruar për lëvizje të lirë të qytetarëve të Maqedonisë në Kosovë dhe Shqipëri vetëm me letërnjoftime.

Gjithashtu zhvillimi i bashkëpunimit midis këtyre shteteve do ti paraprijë realizimi i seancave të përbashkëta qeveritare, marrëveshje bilaterale ku do të krijohen mundësi të reja të zhvillimit ekonomik, rritje e standardit jetësor në ngritjen e vetësdijes së njerëzve.

Hapjes së prespektivave për integrimin e Maqedonisë në Nato dhe BE, mbështetje të madhe i jep edhe SHBA, e cila përshëndet vendosshmërinë e Maqedonisë për tejkalimin të të gjitha çështjeve të hapura në marrëdhënie me fqinjët.

Sigurisht që Maqedonia ka prioritet reformat gjithëpërfshirëse në vend për realizimin e qëllimeve më të larta strategjike të politikës së jashtëm-integrimit në Nato dhe EU.

2. Ballafaqmi i RM-së me problemet e brendshme të shtetit

Pas konfliktit të armatosur shqiptaro-maqedonas të 2001 në R.M-së, i cili erdhi si pasojë e raporteve jo të drejta shoqërorë politike ndërmjet shqiptarëve dhe maqedonasve, si dy etnitet më të mëdha në vend, konflikti që përfundoi me nënshkrimin e Marveshjes së Ohrit dhe që i dha fund konfliktit të armatosur të vitit 2001, problemet brendshme të shtetit ende vazhdojnë të jenë faktor kryesorë mbi krijimin e politikave për veprimin e sigurisë në funksion të paqes, sigurisë dhe stabilitetit të shtetit.

Vitet e fundit Maqedonia përballë me problemet të cilat si rezultat i politikës së deritashme nga qarqe të caktuara politike nuk i kontribuan vendit për integrimin në strukturat euro-atlantike.

Perveç problemeve politike që do të cekim më poshtë, Maqedonia ballafaqohet me probleme si krimi i organizuar, terrorizmi, konflikti ndëretnik, degradimi ekologjik, transformimi i ngadaltë i proceseve demokratike, gjendja e rëndë ekonomike, korrupsioni etj.

Problemet politike të brendshme që e karakterizojnë këtë shtet në dhjetvjeçarit e fundit kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërmjet pushtetit dhe opozitës, përkeqësimi i marrëdhënive ndëretnike, implementimi i Marveshjes së Ohrit, marrëdhëniet me fqinjët, kontesti me emrin si kusht për BE dhe Nato, skandale në sistemin e sigurisë lidhur me shfrytëzimin e tij për qëllime politike etj.

Sa i përket përkeqësimit të marrëdhënive ndëretnike, të motivuara politikisht, shteti nuk shënon progres. Kjo më së miri shifet edhe nga deklaratat e komisionerëve të huaj dhe raporteve të ndryshme, që institucionet më të larta shtetërore, politikatat e tyre të orientojnë në

dialogun dhe bashkëpunimin etnik i cili është element kryesor i stabilitetit politik dhe ekonomik të vendit. Mos harrojmë të potencojmë se situata ndëretnike eskaloj me shqiptimin e dënimeve nga ana e gjykatave të shtetit, për raste të montuara ndaj shqiptarëve.

Marrëdhëniet e përkeqësuar ndërmjet pushtetit dhe opozitës eskaluan me aferën e përgjimeve të funksionerëve të institucioneve shtetërore, afëra këto që më së miri vunë në pah R.M-së shtetin i cili nuk sundon ligji, shtet në të cilin janë bërë keqpërdorime të mëdha financiare dhe shtet në të cilin nuk respektohen liritë dhe të drejtat themelore të njeriut.

Nga kjo situatë u pa qartë se kriza institucionale duhej të tejkalohet, për të ardhmen dhe funksionimin e R.M-së si shtet.

Sigurisht që me ndërmjetsimin e BE-së, ujdia polike midis partive politike në Maqedoni, u arrit me një marrëveshje të ashtquajtur Marrëveshja e Përzhinos me 2 qershor-15 korrik 2015, qëllimet e të ciles ishin që në vend të parë partitë ta vendosin interesin e shtetit dhe konfirmojnë përkushtimin e tyre ndaj procesit EuroAtlantik dhe parimeve demokratike, të konsolidohet zhvillimi ekonomik dhe demokratik, të perforcohen marrëdhëniet ndëretnike, të sigurohet implementimi i plotë i Marrëveshjes së Ohrit, të porfocohen marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe pozita ndërkombëtare e vendit, dhe në këtë mënyrë ta sjellin më afër qëllimit në rrugën e saj euro-atlantike.⁵⁵

E ashtu quajtura periudha e tranzicionit, filloi menjëherë pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje e cila do të përfundojë me zgjedhje të lira dhe demokratike. Nga kjo marrëveshje u emërua edhe prokurori i ri special me autonomi të plotë i cili do të udhëheq hetimin për rastin e përgjimeve.

Pakënaqësia e qytetarëve të RM-së nga ky ralisht, rezultoi me zgjedhje të udhëheqësve të rinj të pushtetit, të cilët u zotuan për shtet të së drejtës, shtet i cili aspiron strukturat euro-atlantike si mundësi e vetme për daljen nga kriza politike.

Mirëpo edhe pas zgjedhjeve, tensionet ndërmjet partive politike ende nuk janë të stabilizuara.

⁵⁵ Marrëveshja e Përzhinos

Gjuha e urrejtjes e përdorur nga udhëheqes të partive politike ne vend, për të shprehur nacionalizmin e tyre, rezultoi me ngjarjet e 27 prillit, në të cilën u slumua institucioni më i lartë shtetëror, Kuvendi i R.M-se nga qytetarë të cilët i përksinin kryesisht bllokut opozitarë, nacionalizmi i të cilëve arriti kulmin, me rrahjen e shumë deputetëve brenda në kuvend.

Pas trazirave në kuvend, prokuroria publike për ndjekje të krimit të organizuar dhe korupsionit, pas ndërmarjes të të gjitha procedurave për vërtetimin e fakteve në lidhje me ngjarjet e 27 prillit, pas procedurës parahetimore, urdhëroi procedurë hetimore për 36 persona, nën dyshimin për kryerjen e veprës penale Kërcënimi terrorist i rendit kushtetues dhe sigurisë të nenit 313 të Kodit penal të R.M-së.

Nga kjo ngjarje, i arrestuar është edhe ish drejtori i Biros për zbulim dhe kundër zbulim Mitko Çavkov, si zyrtar kompetent i cili nuk kishte komanduar dërgimin me kohë të forcave shtesë të policisë për të mbrojtur institucionin më të lartë ligjvënës dhe deputetët e rrezikuar brenda tij.

Te involvuar në këtë rast janë edhe deputet të cilët hapën dyert e parlamentit dhe shumë qytetarë të tjerë, të cilët gjenden në paraburgim.

Në lidhje me ekzistimin e agjencive të huaja sekrete që veprojnë në R.M-se, dilemat janë të mëdha. Kjo mund të konstatohet edhe nga pjesëmarrja e agjentit të huaj serb në trazirat e 27 prillit në Kuvendin e R.M-së, Goran Zhivaleviq, si zëvendës drejtor i Agjencisë informative të Sigurisë-BIA, tani oficer aktiv që punon në Ambasadën në Shkup.

Sipas burimeve, Zhivaleviq ka paranu se ka qenë pjesmarrës në këtë incident me arsyetimin se ka qenë në detyrë për të parë nëse në incident ka edhe persona nga Serbia, tifoze apo edhe ekstremistë.

Mirëpo nga MPB dhe nga Ministria e Punëve të Jashtme e Maqedonisë nuk ka asnjë reagim, sepse nuk janë ndërmarrë masa kundër kundërzbuluesit Goran Zhivaleviq për prezencën e tij në Parlament me 27 Prill.⁵⁶

⁵⁶ www.koha.mk

Nga kjo situatë politike e krijuar në vend, sipas disa ekspertëve nuk ka qenë e përjashtuar mundësia e inskenimit të ndonjë konflikti qytetar madje edhe ndërshtetëror pasi vendi ndodhet ne situatë ku zyrtarë të lartë në pushtet janë të zhytur në krim të organizuar.

Vazhdimësia e situatës politike në vend drejt përmisimt të marrëdhënieve ndëretnike duhet të shenoj progres, në qoftë se Maqedonia, faktori politik i saj të ardhmen e këtij vendi e shohin drejt Bashkimit Evropian, ndërsa sa i përket përmisimit te marrëdhënive midis pozitës dhe opozitës në vend, që njëherit është edhe kusht themelor për integritime ku reformat në shtet do të duhej të realizohen në bashkpunim të ndersjelltë.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

- Republika e Maqedonisë përballlet me sfida të ndryshme politike dhe ekonomike, sfida të cilat ndikojnë dukshëm në punën joefikase dhe të drejtë të sektorëve të sigurisë në zbatimin e plotë të ligjit.
- Kushtet ekonomike e veçanarisht papunësia si problem social dhe varfëria e cila sjell mungesën e mjeteve për egzistencë si faktor objektiv, luanë rol të madh në çregullimin e sjelljeve individuale, çregullime këto që ndikojnë në paraqitjen e sjelljeve kriminale të cilat drejtpërsëdrejti vështirësojnë egzistencën e popullsisë.
- Sistemi i drejtësisë së Maqedonisë është një ndër më të kritikuarit. Mbetet shqetësuese rritja e numrit të madh të krimeve dhe gjithashtu kritika të mëdha adresohen në sistemin gjyqësor.
- Sistemi i drejtësisë në vend nuk është korekt ndaj zbatimit të legjislacionit. Kjo shihet qartë në të gjitha rastet e montuara ndaj shqiptarëve.
- Kusht i pakontesueshëm për R.M-së është integrimi i bashkësive etnike në R.M-së në një sistem shtetëror multietnik.
- Republika e Maqedonisë duhet të bëjë përpjekje maksimale për implementimin e dispozitave për barazi të bashkësive etnike në R.M-së.
- Mos kultivimi i raporteve të mira ndëretnike kërcënon dukshëm stabilitetin, sigurinë dhe të ardhmen e vendit.
- E ardhmja e Republikës së Maqedonisë është në integrimet euro-atlantike.
- Zhvillimi ekonomik në R.M-së dhe mbrojtja e resurseve të vendit është kusht i pakontestueshëm për përparimin e vendit.
- Republika e Maqedonisë duhet të jep angazhim maksimal dhe të qartë, garanci dhe instrumente konkrete për respektimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.
- Sistemi i sigurisë së një vendi duhet të jetë i orientuar në mirrëmbajtjen e sigurisë në aspektin ekonomik, diplomatik poashtu edhe në aspektin politik.

- Sistemi i sigurisë së R.M-se duhet të jetë i orientuar në mbrojtjen e interesave vitale të shtetit si mbrojtja dhe avansimi i paqes dhe sigurisë, mbrojtja e jetës, shëndetit, pronës dhe sigurisë individuale të qytetarit të R.M-së.
- Demokracia si sistem politik i udhëheqjes në vend duhet të avansohet në drejtim të funksionimit të shtetit të së drejtës-pluralizmit politik, ndarja e pushtetit dhe zgjedhje të lira dhe demokratike etj.
- Në Sistemin e sigurisë së R.M-së duhet të bëhen reforma rrënjësore të cilat në vetë i përmbajnë reformat në të gjitha institucionet shtetërore si dhe reformat në institucionet të cilat janë kompetente për mbrojtjen e shtetit dhe qytetarëve, reformat në strukturat ushtarake, policinë, sistemin gjyqësor, reforma këto të cilat nuk do mund të realizohen pa ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare me pranimin e normave juridike dhe standardeve euroatlantike nga ana e R.M-së.
- Sistemi i drejtësisë dhe sistemi i sigurisë duhet të zhvillojnë politikat drejtë integritetit të strukturave të vendit në ato ndërkombëtare.
- Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes janë të obliguara në mirrëmbajtjen e sigurisë dhe stabilitetit në vend.
- Bashkpunimi ndërmjet institucioneve shtetërore është i pashmangshëm për realizimin e reformave dhe luftimin e të gjitha formave të kriminalitetit.
- Transformimi i sektorit të sigurisë dhe përshtatshmëria në sektorin e ndërtimit të sigurisë së R.M-së si kandidat për anëtarësim në BE dhe NATO, me kriteret e vendeve anëtare është i pashmangshëm.
- Maqedonia ka prioritet reformat gjithëpërfshirëse në vend për realizimin e qëllimeve më të larta strategjike të politikës së jashtme-integritetit në NATO dhe EU por qeveria duhet të jetë më aktive dhe të shprehë gadishmëri dhe vullnet për përmbushjen e kërkesave të ndërkombëtarëve dhe të gjejë zgjidhjen e problemeve dhe mangësitë që pengojnë anëtarësimin në BE dhe Nato.

BIBLIOGRAFIA

I. TEKSTE UNIVERSITARE, PUBLIKIME DHE RAPORTE

- Арнаудовски Љупчо, Пенологија: наука за извршување на кривичните санкции, Скопје, 1998
- Арнаудовски Љупчо и Груевска-Дракулевски Александра, Закон за извршување на санкциите: интегрален текст со предговор, кратки објаснувања и регистар на поимите со прилози, Скопје, 2011 „Студиорум“-Центар за регионални истражувања и соработка.
- Azizi Abulla, Bashkimi Evropian, Tetovë, 2010
- Fjalim në konferecën ndërkombëtare- Reformat në sektorin e sigurisë së R.M-së dhe ndikimi i tyre në luftën kundër kriminalitetit e mbajtur më 15.09.2012 në UEJL,
- Gruda Zejnulla, Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, Prishtine, 2000
- Halili Ragip, Viktimologjija, Prishtinë, 2007
- Haziri Fatos, E drejta e policisë, Prishtine, 2010
- Ismaili Ymer, Konflikti i armatosur në Maqedoni-2001, Ymer Ismaili, 2009
- Kambovski Vllado, Kodi penal, Shkup, 2008
- Камбовски Владо, Организиран Криминал, Скопје, 2 Август 2005 С-Штип
- Камбовски Владо и Тупанчески. Никола, Казнено право – посебен дел, Петто, изменето и дополнето издание, Скопје, 2011
- Koncepti nacional për siguri dhe mbrojtje i RM-së
- Каневчев Методија, Кривичен законик – интегрален текст, Скопје, 2 Август 2010
- Каневчев Методија, Практикум за кривично право-посебен дел, Скопје, 2003 НИП „Студентски збор“
- Kotovčevski.M, Sovremen terorizam, Makedonska civilizacija, Skopje, 2003
- Libri i bardhë i mbrojtjes
- Luarasi Aleks, Kodi i procedurës penale, Tiranë, 2005
- Maliqi Nazmi, Revistë studimore shkencore, 2012

- Maliqi Nazmi, Revistë studimore shkencore, 2013
- Marrëveshja e Ohrit
- Rregullorja e punës së Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi
- Osmani Afrim, Kodi penal I R.M-së, Shkup, 2015,
- Osmani Afrim, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2010
- Osmani Afrim, Komentimi I ligjit për egzekutimin e sanksioneve, Shkup, 2013
- Rajkovcevski Rade, Ndërtimi i politikës së sigurisë, Rasti i R.M, Shkup
- Sahiti Ejup; Zejneli Ismail, E drejtë e procedurës penale, Tetovë, 2007
- Salihu Ismet, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2008
- Strategjia e mbrojtjes
- Shabani Fisnik, Mekanizmat juridike për mbrojtjen e lirisë dhe të drejtave të njeriut në R.M, Tetovë, 2016,
- Uka Bajram, Dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë, Prishtinë, 2006
- Vasilevski Voislav, E drejta ndërkombëtare në konfliktet e armatosura, Shkup, 2003
- Zeneli Ismaili, E drejta penale-pjesa e posaçme, Tetovë, 2007,
- Zenku Mendim, Kuptimi mbi të drejtat e njeriut ,pritja e respektimi i tyre kusht për zhvillimin e demokracisë në Maqedoni, Kercovë, 2013

II. LIGJET

- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë
- Kodi penal i R.M(Gazeta Zyrtare nr. 37/1996; 80/1999; 4/2002; 43/2003; 19/2004; 81/2005; 60/2006; 73/2006; 7/2008; 139/2008; 114/09)
- Kodi Penal I Kosoves
- Kodi Penal I Republikes se Shqiperise
- Kodi penal me komentim Prof.Dr.jovan Proevski ,Agjencioni Akademik Shkup, 1998
- Ligji për avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pjesëtarëve të bashkësive që janë më pak se 20% nga popullsia në RM (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 92/2008)
- Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 50/2010)
- Ligji për procedurë penale (Gazeta zyrtare e RM nr.150/10)

- Ligji për egzekutimin e sanksioneve penale (Gazeta zyrtare e PM nr. 2/06, 57/10).
- Ligji për kundravajtje (Gazeta zyrtare e RM nr. 62/06)
- Ligji për gjykatat (Gazeta zyrtare e RM nr.58/06)
- Ligji për punë të brendshme (Gazeta zyrtare e RM nr.127/2016)
- Ligji i mbrojtjes(Gazeta zrtare e RM nr. 155)
- Ligji për mbrojtje sociale (Gazeta zyrtare e RM nr.79/09)
- Mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Anica Tomshiq-Stojkovska & Donçe Boshkovski, 2011
- Përmbledhje e ligjeve penale

III. Burimet nga Web –Faqet e Internetit

<http://www.akademik.mk>

<http://www.shenja.tv>,

[http:// www.alsat-m.tv](http://www.alsat-m.tv), 5 koriik,

[http:// www.arm.mil.mk/baza/struktura/struktura.html](http://www.arm.mil.mk/baza/struktura/struktura.html)

<http://www.siofa.gov.mk>

<http://ministerstvo> za vnatresni raboti na RM

<http://ministerstvo> za odbrana na Rm

http://sq.Wikipedia.org/wiki/T%C3%AB_Drejtat_e_Njeriut

http://en.Wikipedia.org/wiki/Human_rights_in_the_Republic_of_Macedonia

http://sq.wikibooks.org/wiki/III._LIRITE,_TE_DREJTAT_DHE_DETYRAT_E_NJERIUT_DHE_TE_QYTETARIT

<http://www.pravo.org.mk/>

<http://www.sobranie.mk/default-MK.asp>

<https://kallxo.com/dosja-e-prokurorise-maqedone-per-grupin-e-kumanoves/>